KUADRI LIGJOR DHE PRAKTIKA E QEVERISJES SË KORPORATAVE NË SEKTORIN BANKAR SHQIPTAR

Roden Pajaj*
Rezart Ferzaj

**Roden Pajaj, Drejtor i Departamentit të Burimeve Njerëzore në Bankën e Shqipërisë dhe Rezart Ferzaj, Këshilltar i Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.*
Pikëpamjet e shprehura në këtë punim janë të autorëve dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht ato të institucioneve përkatëse për të cilat punojnë.

Falënderojmë Prof. Georges Selim për drejtimin, sugjerimet dhe komentet inkurajuese. Falënderojmë anëtarët e grupit të punës të Bankës së Shqipërisë dhe më në veçanti punonjësit e departamenteve të Kërkimit, Burimeve Njerëzore dhe Mbikëqyrjes për ndihmën dhe bisedat e gjata dhe frytdhënëse. Barra për pjesën tjetër i mbetet autorëve.

PËRMBAJTJA

Përmbledhje 7

1. Hyrje 8

2. Vështrim i përgjithshëm i Shqipërisë dhe analiza teorike 11

2.1 Vështrim i përgjithshëm i Shqipërisë 11
2.1.1 Zhvillime ekonomike 11
2.1.2 Sektori financiar 12
2.1.3 Vështrim mbi sektorin bankar në Shqipëri 14
2.1.4 Tregjet e kapitalit 15

2.2 Qasja teorike dhe literatura 16
2.2.1 Teoria e agjencisë 17
2.2.2 Teoria e aktorëve të interesuar 19
2.2.3 Modelet e ndikuesve të jashtëm dhe të brendshëm në qeverisjen e korporatave 20
2.2.4 Konvergimi i sistemeve 25

2.3 Qeverisja e korporatave në banka 26
2.3.1 Dallimet e bankave nga kompanitë e tjera 27
2.3.2 Aspekte të rëndësishme të strukturës së kapitalit të bankave 27
2.3.3 Problemet e agjencisë specifike për bankat 29

2.4 Lidhja midis qeverisjes së korporatave dhe rregullimit 32

2.5 Reagimi ndërkombëtar ndaj krizës financiare për forcimin e qeverisjes së korporatave në banka 33
2.5.1 Komiteti i Bazelit për Mbikëqyrjen Bankare 33
2.5.2 Qeverisja e korporatave në BE 34

2.6 Qeverisja e korporatave në ekonomitë në tranzicion 36

3. Qeverisja e korporatave në Shqipëri 39

3.1 Një model për qeverisjen e korporatave për Shqipërinë 39
3.1.1 Reformat në kuadrin ligjor të qeverisjes së korporatave 39

3.2 Situata aktuale 46
3.2.1 Publikimi i informacionit financiar 48
3.2.2 Struktura e pronësisë 48
3.2.3 Mjedisi ligjor - sundimi i së drejtës 50

4. Qeverisja në bankat shqiptare 52

4.1 Vështrim i përgjithshëm 52
4.1.1 Kriza financiare në sektorin bankar shqiptar 52
4.1.2 Konkurrenca dhe struktura e pronësisë e bankave që veprojnë në Shqipëri 54

4.2 Kuadri ligjor për qeverisjen e bankave në Shqipëri 57
4.2.1 Kualifikimet dhe kuptimi i rolit të anëtarëve të Bordit 58
4.2.2 Objektiva strategjikë dhe vlerat e korporatës 62
4.2.3 Linja të qarta përgjegjësie dhe llogaridhënieje 62
4.2.4 Mbikëqyrja e duhur nga drejtimi i lartë 63
4.2.5 Kontrolli efektiv i brendshëm dhe i jashtëm 64
4.2.6 Politikat e kompensimit 65
4.2.7 Transparenca 66

4.3 Qeverisja e korporatave e zbatuar në sektorin bankar 67

4.3.1 Pavarësia e këshillit drejtues në bankat shqiptare 68
4.3.2 Çfarë mendojnë bankat për kualifikimet e anëtarëve të këshillit? 71
4.3.3 A i përmbushin bankat kërkesat ligjore për publikimin e informacionit dhe transparencën? 72
4.3.4 Rezultatet e analizave 73

5. Përfundime dhe rekomandime 74

Bibliografi 77

PËRMBAJTJA E TABELAVE

Tabelë 2.1	*Tabelë krahasuese e sistemit të ndikimit të brendshëm dhe atij të jashtëm*	*25*
Tabelë 4.1	*Struktura e pronësisë dhe numri mesatar i aksionerëve në bankat që veprojnë në Shqipëri*	*55*
Tabelë 4.2	*Indeksi Herfindahl Hirschman (HHI)*	*56*
Tabelë 4.3	*Numri i anëtarëve të pavarur në këshillat drejtues të bankave shqiptare*	*69*

PËRMBAJTJA E GRAFIKËVE

Grafik 3.1	*Cilësia e qeverisjes së korporatave dhe legjislacionit në Shqipëri*	*47*
Grafik 3.2	*Sipërmarrjet aktive sipas numrit të punonjësve (Përqindja e SME-ve)*	*49*
Grafik 3.3	*Përqindja e sipërmarrjeve aktive sipas formës ligjore*	*50*
Grafik 3.4	*Numri i sipërmarrjeve aktive sipas formës ligjore*	*50*
Grafik 4.4	*Roli i aksionerëve në vendime strategjike*	*70*
Grafik 4.5	*Kualifikimet e këshillit*	*72*

PËRMBLEDHJE

Ky material analizon praktikat e qeverisjes së korporatave dhe kuadrin e saj ligjor në sistemin bankar shqiptar. Kohët e fundit, janë rishfaqur çështjet e "hendekut" midis rregullimit bankar dhe qeverisjes së korporatave, të nxjerra në pah nga kriza financiare globale si një e metë e shkaktuar nga derregullimi gjatë dekadës së fundit në vendet e zhvilluara. Në ekonomitë në tranzicion, këto hendeqe janë rezultat i sfidave të tranzicionit, më së shumti të lidhura me konsolidimin e sundimit të së drejtës, strukturën e pronësisë, si dhe kapacitetet profesionale dhe institucionale.

Analiza tregon se modeli i zbatuar i qeverisjes së korporatave në sektorin bankar shqiptar i ngjason modelit të aktorëve të brendshëm të qeverisjes së korporatave, çfarë është në kundërvënie me modelin e dizenjuar nga kuadri ligjor dhe rregullator në vend. Gjetjet sugjerojnë se kjo mospërputhje është rezultat i drejtpërdrejtë i zbatimit joefektiv të ligjit, i mungesës së instrumenteve dhe i nxitësve të kontrollit të bazuar në mekanizmat e tregut.

Struktura tejet e përqendruar e pronësisë së bankave shqiptare, i rëndon në mënyrë të theksuar problemet e agjencisë duke prekur, për rrjedhojë, rolin kyç të këshillit drejtues dhe "marrëdhënieve të agjencisë". Kjo është në dëm të interesit të aktorëve të tjerë si depozituesit dhe agjencisë rregullatore, e cila vepron si agjent në interes të publikut.

Autoriteti Mbikëqyrës i veprimtarisë bankare në Shqipëri e percepton qeverisjen e shëndoshë të bankave si një burim endogjen për stabilitetin financiar, besimin e publikut dhe mbrojtjen e konsumatorit. Angazhimi i tij është materializuar vazhdimisht në një gamë të gjerë veprimtarish rregullatore bankare gjatë dhe pas krizës financiare.

Analiza për pavarësinë e këshillit drejtues të bankave tregon se pavarësisht kërkesave ligjore të një standardi të lartë, ka hapësira për një rol më aktiv të autoritetit rregullator bankar shqiptar, në lidhje me zbatimin e këtyre kërkesave, në përputhje me udhëzimet e Komitetit të Bazelit dhe Bashkimit Evropian.

1. HYRJE

Gjatë dhjetëvjeçarit të fundit, qeverisja e korporatave është bërë një çështje gjithmonë e më e rëndësishme në Shqipëri. Ky zhvillim është në përputhje me përpjekjet e vendit për të krijuar një klimë biznesi të shëndetshme, për të tërhequr investime të reja dhe për të zhvilluar tregun e kapitalit.

Transformimi i ekonomisë së Shqipërisë nga një ekonomi e izoluar dhe e centralizuar në një ekonomi të tregut dhe të hapur kërkonte hartimin dhe zbatimin e një kuadri të ri ligjor. Kusht për suksesin e procesit do të ishte vëmendja e duhur ndaj ndërtimit të kapaciteteve institucionale dhe njerëzore. Pavarësisht se shumë prej qëllimeve janë arritur, rruga ka qenë plot sfida të vështira dhe ende ka nevojë për përmirësime të qenësishme. Të gjitha këto zhvillime ndikojnë drejtpërdrejt mbi praktikat e qeverisjes së korporatave, duke përcaktuar në një shkallë të madhe modelin dhe cilësinë e saj.

Studimi përqendrohet në çështje të qeverisjes së bankave në lidhje me strukturën e bilanceve financiare të tyre dhe me kërkesat rregullatore. Kjo, kryesisht për shkak të rolit të tyre kyç në shpërndarjen e kapitalit në ekonomi, si dhe rëndësinë e madhe që ato kanë për stabilitetin financiar të Shqipërisë dhe prospektet e rritjes ekonomike të saj. Analiza fillon me një përshkrim të lidhjes midis qeverisjes së korporatave dhe rregullimit bankar nga këndvështrimi i stabilitetit financiar. Gjetjet e kësaj analize tregojmë se rregullimet bankare si dhe veprimet apo mosveprimet e autoritetit rregullator - si agjent i interesit publik – kanë ndikim të rëndësishëm mbi problemet e agjencisë te bankat. Më tej, duke pasur parasysh mungesën e funksionimit të bursës në Shqipëri, autorët besojnë se praktikat e shëndosha të qeverisjes së bankave mund të shërbejnë si forcë e jashtme mbi praktikat e qeverisjes së kompanive të tjera.

Qëllimi i studimit është të japë rekomandime për zhvillimin e politikave qeverisëse, pas analizimit dhe identifikimit të qartë të modelit të qeverisjes së korporatave në Shqipëri. Gjithashtu, ky material identifikon faktorët që pengojnë dhe dekurajojnë qeverisjen e shëndoshë të korporatave. Qasja kryesore teorike e

tij mbështetet në parimet e OECD-së, rekomandimet e Bazelit, raportet e institucioneve ndërkombëtare si BERZH, Banka Botërore dhe IFC, si dhe një sërë materialesh diskutimi dhe tekstesh akademike. Ndonëse nuk përdoren në mënyrë eksplicite aplikimet empirike të modeleve teorike, ky studim ilustron dhe mbështet argumentet e tij duke përdorur të dhëna nga vrojtime të Bankës së Shqipërisë, raporte vjetore të bankave, INSTAT dhe Raporti i Progresit i Komisionit Evropian për Shqipërinë.

Kreu i dytë, përmbledh shkurtimisht zhvillimin e përgjithshëm të Shqipërisë, që prej fillimit të tranzicionit, duke u fokusuar në zhvillimin e sistemit financiar. Në të shpjegohet se si privatizimi i bankave, krijimi dhe rënia e skemave piramidale, roli i tregut të kapitalit (ose mungesa e tij) dhe konsolidimi i sistemit bankar gjatë dekadës së fundit kanë ndikim domethënës në praktikat e qeverisjes së korporatave në Shqipëri.

Në pjesën e dytë të kreut 2, parashtrohet themeli teorik i analizës së studimit duke u përqendruar në dy teori kyçe: Teorinë e Agjencisë dhe Teorinë e Aktorëve. Këto teori kanë çuar në dy prej modeleve më përfaqësuese të qeverisjes së korporatave, modelin e aktorëve të brendshëm dhe atë të aktorëve të jashtëm, të cilëve u referohemi kur vlerësojmë sektorin bankar shqiptar.

Në pjesën e tretë paraqitet literatura teorike për qeverisjen e korporatave në banka, duke u përqendruar në teoritë e zhvilluara pas krizës financiare të viteve 2007-2009. Më tej, vijojnë argumente të detajuara të dallimeve mes bankave dhe sipërmarrjeve të tjera të zakonshme, të tilla si struktura e kapitalit në banka, rrjedhjet e depozitave prej tyre (të ashtuquajturat *bank runs*), paqartësia e bilanceve financiare të bankave, profilet e rrezikut dhe lidhja e ndërsjellë mes tyre. Në vijim, paraqitet një tablo e detajuar e "problemeve të agjencisë" në banka, dhe se si këto probleme ndikojnë në rolin e autoritetit rregullator. Marrëdhënia plotësuese midis qeverisjes së korporatave dhe rregullimit bankar trajtohet në pjesën e katërt të kreut.

Dy pjesët e fundit të kreut 2 flasin për zhvillimet më të fundit mbi qeverisjen e korporatave pas krizës, të nxitura kryesisht nga

Komiteti i Bazelit për Mbikëqyrjen Bankare dhe reagimi i BE-së ndaj turbulencës financiare. Kreu mbyllet me një vështrim mbi ekonomitë në tranzicion, duke vënë theksin në karakteristikat e përbashkëta, të tilla si tregje financiare të pazhvilluara, mbrojtje ligjore e pamjaftueshme për investitorët dhe aksionerët e pakicës, mungesë transparence dhe mungesë e drejtuesve të kualifikuar.

Kreu 3, paraqet me hollësi analizat e autorëve për identifikimin e modelit të qeverisjes së korporatave në Shqipëri, me fokus në kuadrin ligjor dhe zbatimin e tij. Fokusi kryesor i këtij kreu është paraqitja e fakteve dhe rezultateve mbi qeverisjen e korporatave në Shqipëri, duke theksuar çështje kritike, si publikimi i informacioneve financiare, struktura e pronësisë dhe efektiviteti i ligjit.

Ndërsa tre krerët e parë shërbejnë si sfond solid për trajtimin e imtësishëm të qeverisjes së bankave, pjesa e parë e kreut 4, synon të paraqesë një kuptim më të qartë të sistemit bankar në Shqipëri, si ai u ndikua nga kriza, ndikimin që ka konkurrenca në qeverisjen e bankave, strukturën e pronësisë dhe performancën e sektorit në përgjithësi.

Në pjesën e dytë të kreut 4, studimi analizon me hollësi kuadrin ligjor dhe rregullator, i cili përcakton aspekte të qeverisjes së korporatave, si kualifikimi i këshillit drejtues, pavarësia e tij, objektivat strategjike dhe vlerat e korporatës, transparencën, sistemet e kontrollit, etj.

Kreu 4 mbyllet me një interpretim të rezultateve të vrojtimeve për qeverisjen e bankave në Shqipëri dhe të dhëna të tjera të disponueshme, përfshirë materiale të botuara nga bankat. Përgjatë analizës, studimi përqendrohet në çështje, si faktorët që ndikojnë në cilësinë e performancës së këshillit, të tilla si: pavarësia, kualifikimet, mendimi strategjik dhe vendimmarrja, si dhe niveli i transparencës mbi praktikat e qeverisjes së korporatave.

Kreu 5 paraqet përfundimet dhe rekomandimet për aktorët politikëbërës, si dhe sugjeron mënyra të ndryshme për përmirësimin e qeverisjes së korporatave.

2. VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM I SHQIPËRISË DHE ANALIZA TEORIKE

2.1 VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM I SHQIPËRISË

Në dy dhjetëvjeçarët e fundit, Shqipëria, si shtet dhe shoqëri, ka kaluar një tranzicion relativisht të gjatë nga një totalitarizëm komunist 50-vjeçar drejt një regjimi demokratik e të ekonomisë së lirë të tregut. Ndër të tjera, periudha e tranzicionit, ndryshoi kursin e marrëdhënieve gjeopolitike dhe diplomatike me pjesën tjetër të botës, ku integrimi në Bashkimin Evropian (BE) zëvendësoi politikat izoluese dhe ksenofobe. Në kuadrin e këtyre zhvillimeve, Shqipëria u bë anëtare e Organizatës Botërore të Tregtisë (OBT) më 8 shtator 2000 dhe nënshkroi Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit (MSA) me BE-në në vitin 2005. MSA-ja shërben si një instrument kalimtar (për një periudhë 10-vjeçare) i hartuar për të rritur standardet dhe vlerat e Shqipërisë, duke e sjellë vendin më afër BE-së. Shqipëria hyri në NATO më 1 prill 2009 dhe qeveria po punon për përmbushjen e kushteve të BE-së për statusin e vendit kandidat.

Përveç zhvillimeve pozitive, tranzicioni shqiptar ka qenë i shoqëruar edhe me dukuri negative të tilla si papunësi e lartë dhe e vazhdueshme, korrupsion, institucione të dobëta dhe treg pjesërisht i lirë. Ndonëse fenomene të zakonshme të tranzicionit, këto probleme vazhdojnë të jenë ende lajtmotiv i jetës politike dhe sociale të Shqipërisë. Pavarësisht nga përparimi i bërë në shumë fusha, hapat drejt integrimit në BE janë mjaft të ngadaltë. Shpeshherë, mjedisi tejet i polarizuar politik pengon arritjen e objektivave kryesore të vendit, duke çuar në ngërçe politike dhe vendimmarrëse që shtyjnë vazhdimisht marrjen e statusit të vendit kandidat nga Shqipëria (EC 2011).

2.1.1 ZHVILLIME EKONOMIKE

Kalimi në fillim të viteve nëntëdhjetë, nga planifikimi i centralizuar në ekonominë e tregut të lirë, solli ndryshime strukturore rrënjësore në Shqipëri, përfshirë këtu politika të reja makroekonomike dhe reforma strukturore, të tilla si liberalizimi i çmimeve dhe tregtisë,

privatizime në shkallë të gjerë, reforma fiskale, hapje të vendit ndaj kapitalit të huaj etj. PBB-ja u rrit në mënyrë të qëndrueshme me një mesatare prej 6% në vit, deri para mbërritjes së krizave financiare dhe ekonomike botërore të vitit 2008. Ajo ka mbetur pozitive që prej 2008-ës, ndonëse e reduktuar në 3% (Banka e Shqipërisë, 2011). Të dhëna nga Banka e Shqipërisë tregojnë se inflacioni është mbajtur brenda intervalit të objektivit prej 3±1%, ndërsa kursi i këmbimit të lekut kundrejt euros dhe dollarit amerikan ka qenë kryesisht i qëndrueshëm. Më tej, gjatë viteve 2009 dhe 2010, deficiti tregtar dhe ai i llogarisë korrente është tkurrur në mënyrë të konsiderueshme, kryesisht falë ecurisë së mirë të eksporteve shqiptare. Borxhi publik ka arritur 58.44% të PBB-së, ku 25.15% përbën borxh të jashtëm dhe 33.29% borxh të brendshëm. Ndonëse më i lartë se në ekonomi të tjera në zhvillim në vendet e rajonit (FMN, 2011), borxhi publik mbetet brenda kufijve të kritereve ekonomike të Traktatit të Maastrihtit.

Të gjitha karakteristikat e lartpërmendura të ekonomisë shqiptare, të kombinuara me nivelin e ulët të integrimit financiar ndërkombëtar me pjesën tjetër të botës, duken se kanë ndihmuar për në një ndikim të moderuar të krizave botërore ekonomike dhe financiare mbi gjendjen e përgjithshme ekonomike të vendit. Komisioni Evropian, FMN-ja dhe Banka e Shqipërisë konfirmojnë në raportet e tyre se, ndonëse i brishtë, stabiliteti makroekonomik vazhdon të jetë i pranishëm në vend. Megjithatë, disa fusha kyçe si papunësia, deficiti i llogarisë tregtare dhe niveli i borxhit kërkojnë adresim të menjëhershëm.

2.1.2 SEKTORI FINANCIAR

Tregu financiar në Shqipëri mbizotërohet nga bankat, që zënë rreth 95% të sektorit. Institucione të tjera që ushtrojnë veprimtari financiare janë kompanitë e sigurimeve, subjektet financiare jobanka, shoqëritë e kursim-kreditit dhe fondet e pensioneve suplementare private.

Reformat në sektorin financiar kanë qenë të ngadalta dhe të kufizuara. Në fillim të viteve '90, ekzistonin tri banka me kapital shtetëror (Banka e Kursimeve, Banka Kombëtare Tregtare dhe

Banka Tregtare Agrare) në të cilat ishin përqendruar rreth 90% të depozitave, ndërsa numri i bankave private ishte i kufizuar. Pjesa më e madhe e tyre u krijua në gjysmën e dytë të atij dhjetëvjeçari.

Gjatë fillimviteve '90, sistemi financiar u përball me dy zhvillime të rëndësishme: mungesën e tregut të kapitalit dhe rritjen e kursimeve si pasojë e fluksit të madh hyrës të dërgesave të emigrantëve. Një mjedis i tillë favorizoi lindjen e tregut informal financiar, ku kompanitë huazonin kryesisht nga njëra-tjetra apo nga individët, zakonisht me interesa më të larta se interesat e përcaktuar formalisht në tregun e rregulluar. Një prej pasojave më serioze negative të këtij informaliteti ishte lindja e skemave Ponzi (piramidale), të cilat u përhapën me shpejtësi dhe në shkallë të gjerë, gjatë viteve 1994-1996. Favorizuar nga fakti se ekonomia shqiptare ishte pothuajse e bazuar në përdorimin e *cash*-it dhe mbikëqyrja financiare ishte e dobët, kompani financiare të dyshimta filluan të marrin depozita në *cash* nga individët, duke premtuar kthime deri në 50% në vit.

Fullani (2009) argumenton se "për shkak të akumulimit të madh të kapitalit, këto skema nxitën konsumin përtej niveleve të ekuilibrit, duke shtrembëruar raportin kursim-investim dhe duke penguar kanalizimin e kapitalit në investime reale"(f. 229).

Lulëzimi i këtyre skemave konfirmoi nevojën për forcimin e institucioneve mbikëqyrëse si dhe të strukturave e mekanizmave të tregut të lirë në vend. Nisur nga pasojat e rënda të skemave piramidale mbi ekonominë shqiptare, është e rëndësishme të analizohen arsyet që çuan në krijimin e tyre. Çfarë e shtyu 2/3 e popullsisë shqiptare t'i besonte paratë këtyre firmave fantazëm? Shuma totale arrinte pothuaj gjysmën e PBB-së vjetore të vitit 1996 (Jarvis, 1999).

Në analizimin e kësaj dukurie, Jarvis (1999) arrin në përfundimin se arsyet kryesore për krijimin dhe rënien e skemave piramidale në Shqipëri ishin niveli i varfërisë dhe mosnjohja sa duhet e ekonomisë së tregut të lirë, sistemi financiar joeficient, por edhe çështje që lidhen me qeverisjen e korporatave. Ai theksonte nevojën për parandalimin e këtyre dukurive nëpërmjet krijimit të

një sistemi financiar të rregulluar dhe mirëfunksionues, ngritjen e një kuadri rregullator që mbulon si tregjet informale edhe ato formale dhe që ka linja të qarta përgjegjësie për mbikëqyrje dhe veprim, si dhe trajtimin e problemeve të përgjithshme të qeverisjes së korporatave. Ndonëse parandalimi i skemave piramidale nuk duhet të jetë qëllimi parësor i qeverisjes së mirë të korporatave, "përvoja shqiptare është një shembull i fuqishëm i kostove sociale kur kriminaliteti nuk mbahet nën kontroll" (Jarvis, 1999, f. 6).

Nga këndvështrimi i parimeve të qeverisjes së korporatave, ne mund të argumentojmë se nxitësit e krijimit të skemave piramidale ishin mungesa e qeverisjes së mirë e kombinuar me një ekonomi e cila bazohej në përdorimin e *cash*-it në një shkallë të gjerë. Në këtë mjedis, firmat nuk ishin të detyruara të publikonin pasqyrat financiare, ndërkohë që autoriteteve u paraqisnin pasqyra financiare me të dhëna të rreme. Për këtë arsye, autorët argumentojnë se një masë kyçe për parandalimin e këtyre ngjarjeve është edhe respektimi i parimeve të qeverisjes së korporatave.

2.1.3 VËSHTRIM MBI SEKTORIN BANKAR NË SHQIPËRI

Sektori bankar shqiptar përbëhet nga 16 banka, ku prania e kapitalit të huaj është mbizotëruese (Banka e Shqipërisë, 2011, f. 77). Këtu mund të përmendim filiale të grupeve dhe degë të bankave të huaja, të tilla si Intesa SanPaolo Bank, Raiffeisen Zentrale Bank, Societe Generale, Credit Agricole etj. Shkalla e lartë e pronësisë së huaj ka injektuar përvojat dhe praktikat bankare më të mira në sistemin financiar vendas, së bashku me modernizimin dhe inovacionin nëpërmjet produkteve të teknologjisë së lartë. Më e rëndësishmja, ato kanë ndihmuar për krijimin e standardeve të larta në praktikat organizative dhe të qeverisjes së korporatave.

Kapitali i bankave shqiptare e ka origjinën nga shtete si Austria, Italia, Greqia dhe Franca. Sipas Bankës së Shqipërisë (2011, f. 77), në vitin 2010 aktivet gjithsej të sektorit bankar arrijnë në 7 miliardë euro, duke përfaqësuar 80% të PBB-së. 64% e mjeteve gjithsej të bankave u përkasin katër bankave më të mëdha.

Portofoli i tepricës së kredisë gjithsej ishte rreth 3.5 miliardë euro, duke përfaqësuar 40% të PBB-së në vitin 2010, ku pjesa më e madhe (rreth 70%) e kredisë ishte në valutë.

Kreditë me probleme (NPL), një shqetësim i vazhdueshëm për sektorin bankar, arrinin 16.6% në tremujorin e dytë të vitit 2011 nga 13.6% në fund të vitit 2010. Ky nivel i lartë i NPL-ve mund "të shpjegohet pjesërisht me dobësinë institucionale dhe gjyqësore që kanë penguar ekzekutimin e kolateralit" (FMN, 2011, f. 26).

Depozitat gjithsej në sistemin bankar që prej vitit 2010 kanë vijuar prirjen rritëse, duke u rritur me 18%. Depozitat në monedhën kombëtare janë disi më të larta se ato në monedha të huaja (51.2% kundrejt 48.8%), ndërsa pjesa më e madhe e depozitave gjithsej është përqendruar në pak banka të mëdha. Në vitin 2010, kapitali i aksionerëve është rritur me 9% (Banka e Shqipërisë, 2011. f. 77) dhe sektori bankar mbeti i mirëkapitalizuar (EC, 2011, f. 26) me një raport të mjaftueshmërisë së kapitalit prej 15%.

Sipas raportit të Bankës së Shqipërisë, "Në Shqipëri, sistemi financiar dhe sektori bankar shihen si të qëndrueshëm. Veprimtaria e sektorit bankar është zgjeruar më tej dhe pjesa që ai zë në ekonominë shqiptare është rritur. Treguesit e fitimit janë përmirësuar në krahasim me periudhën pararendëse. Kapitalizimi dhe likuiditeti operues janë në nivele të mira. Nevoja për të përmirësuar cilësinë e kredive mbetet sfida kryesore me të cilën përballet sektori bankar. Ushtrimet e provës së qëndrueshmërisë tregojnë se bankat janë rezistente ndaj goditjeve të presupozuara financiare dhe ekonomike." (Banka e Shqipërisë, 2011, f. 77)

2.1.4 TREGJET E KAPITALIT

Tregjet e kapitalit janë përvojë relativisht e re në Shqipëri. Bursa e Tiranës (BT) u krijua në maj 1996 fillimisht brenda Bankës së Shqipërisë dhe funksionoi e tillë deri në shkurt 2002 (BT, 2002), kur dhe u transformua në një kompani aksionere. Veprimtaria e saj kryesore është tregtimi i bonove të thesarit të qeverisë në tregun parësor (deri në 1998) dhe në atë dytësor. Aktorët kryesorë në tregun e kapitaleve janë qeveria me tituj të borxhit dhe institucionet financiare, që krijojnë

kërkesën për tituj. Duke zhvilluar vetëm këtë lloj veprimtarie, ende nuk ka tregtim të titujve në treg dhe listim të kompanive.

Arsyet e perceptuara më gjerësisht për mosfunksionimin e BT-së janë mungesa e transparencës dhe pasqyrat financiare të shtrembëruara nga kompanitë, me qëllim shmangien nga detyrimet tatimore. Për këtë arsye, nevojat për financim të kompanive plotësohen kryesisht nga sistemi bankar dhe tregu informal i huave. Në dallim nga kriteret e forta për financim në tregjet e kapitalit, shpesh bankat janë të detyruara t'i vlerësojnë kompanitë në bazë të pasqyrave financiare jozyrtare (të ashtuquajturat "pasqyra reale"). Për rrjedhojë, financimi i kapitalit nëpërmjet listimit në bursë nuk është një formë tërheqëse financimi për kompanitë në Shqipëri, për sa kohë ato gjejnë financim tek bankat të cilat pranojnë të dhëna financiare jozyrtare.

2.2 QASJA TEORIKE DHE LITERATURA

Gjatë dy dhjetëvjeçarëve të fundit, çështja e qeverisjes së korporatave është bërë gjithnjë e më e rëndësishme. Gjatë kësaj periudhe, shumë kriza financiare kanë nxjerrë në pah si një prej shkaqeve kryesore qeverisjen e dobët të korporatave. Ajo mbulon disiplina të ndryshme, përfshirë financën, kontabilitetin, ligjin dhe jurisprudencën, menaxhimin, etikën e biznesit dhe politikëbërjen. Çdo krizë ka ngritur shqetësime mbi elementë të veçantë të qeverisjes së korporatave. Megjithatë, këta elementë përcaktojnë një sistem parimesh të bashkëlidhura e të ndërvarura me njëra – tjetrën (Kirkpatrick 2009 dhe Wearing 2005).

Në literaturë, ekzistojnë qasje të ndryshme teorike për shpjegimin e qeverisjes së korporatave, të cilat përdorin terminologji dhe teknika të ndryshme. Këto qasje burojnë nga sisteme specifike ekonomike, sociale dhe ligjore, si dhe sfonde të ndryshme historike. Teoritë kryesore - njëkohësisht më të debatuarat - janë Teoria e agjencisë dhe Teoria e aktorëve (Smerdon, 2010). Me qëllim analizimin dhe identifikimin e duhur të veçorive specifike që i dallojnë bankat nga llojet e tjera të sipërmarjeve, këto dy lloj modelesh të qeverisjes së korporatave përshkruhen më tej në mënyrë sintetike.

2.2.1 TEORIA E AGJENCISË

Teoria e agjencisë u zhvillua paralelisht me krijimin dhe zhvillimin e tregut të aksioneve, si burim i ri financimi për kompanitë. Para ekzistencës së tregut të aksioneve, kompanitë merrnin financim për aktivitetin e biznesit nga individët, në marrëdhënie familjare që vepronin njëkohësisht si pronarë dhe drejtues të kompanisë. Për shkak të nevojave në rritje për zgjerim të aktivitetit, lindi nevoja për burime të tjera financimi. Kjo solli zhvillimin e tregut të aksioneve si mjet për të mbledhur kapital, duke emetuar aksione për investitorë të rinj të cilët ktheheshin në aksionerë. Tregu i aksioneve ofronte një mundësi jo vetëm për të blerë aksione, por edhe për të gjeneruar të ardhura nga tregtimi i tyre, duke shkaktuar, kësisoj, ndryshime të shpeshta të strukturës së pronësisë të kompanisë. Këto zhvillime zunë fill në Mbretërinë e Bashkuar dhe në SHBA (Solomon, 2010).

Themelet e Teorisë së agjencisë, të referuar në literaturë edhe si "Teoria Principal - Agjent" ose "Vlera e Aksionerit", bazohen në ndarjen e pronësisë nga kontrolli mbi kompaninë. Sipas kësaj teorie, aksioneri - principali - i delegon menaxherëve - agjentëve drejtimin e kompanisë. Këta të fundit kanë detyrimin për besnikëri ndaj pronarëve, duke njohur e pranuar supremacinë e interesit të aksionerëve - maksimizimin e vlerës së aksioneve - ndaj çdo interesi tjetër (Solomon 2010, Wearing 2005, Minzt 2004, Smerdon 2010, dhe Stephen dhe Backhaus 2003). Agjentët, të cilëve u është besuar drejtimi i përditshëm i biznesit kanë kontrollin real mbi kompaninë, duke krijuar një asimetri midis tyre dhe principalëve. Kjo asimetri është burim për konflikt të interesave ndërmjet principalit dhe agjentit. Shkaku kryesor i këtij problemi ka të bëjë me faktin se menaxherët duke patur më shumë informacion dhe njohuri mbi kompaninë mund të joshen për të vendosur interesat e tyre, si për shembull bonuse më të larta, mbi interesat e aksionerëve. Ky fenomen njihet në literaturë si "problemi i agjencisë". Për të parandaluar këtë problem, shpesh bizneset mbartin kostot e agjencisë, të cilat përfshijnë kostot e monitorimit që rëndojnë mbi principalin, kostot lidhëse që rëndojnë mbi agjentin si dhe kostot që rezultojnë nga reduktimi i mundshëm i vlerës së aksioneve, si pasojë e vendimeve të agjentit, të marra në kundërshtim me interesat e principalit.

Sipas Minzt (2004, f. 4), ndonëse ekziston një larmi zgjidhjesh, "problemi i agjencisë nuk mund të zgjidhet asnjëherë në mënyrë të përsosur". Ilustrime të këtij pohimi mund të gjenden në skandale të shumta të përsëritura në gjithë botën si dhe në krizën globale financiare të viteve 2007-2009.

Zgjidhjet potenciale të këtij problemi, sipas gjetjeve kryesore në literaturë, mund të grupohen si më poshtë:

- Domosdoshmëria e monitorimit të sjelljes së agjentëve nga aksionerët, nëpërmjet ngritjes të një Bordi Drejtues profesional, ku drejtorë të aftë dhe me ekspertizën e duhur ngarkohen me përgjegjësi mbikëqyrëse dhe vishen me kompetencën për të punësuar apo shkarkuar menaxherët.
- Zbatimi i mirë i kontratave, të cilat përcaktojnë qartë të drejtat dhe përgjegjësitë e principalëve dhe agjentëve dhe që janë të hartuara për të formësuar sjelljen e agjentëve në interesin më të mirë të aksionerëve.
- Mekanizëm eficient i tregut për kontrollin e korporatave, i cili "detyron" menaxherët të veprojnë në interesin më të mirë të principalëve, duke ruajtur një vlerë të lartë të aksioneve për të shmangur sipërmarrjet armiqësore (*hostile takeovers*)[1], çfarë mund të shkaktojnë si rrjedhojë, humbjen e vendit të tyre të punës. Një pasojë e mundshme negative e këtij mekanizimi është fokusimi i menaxherëve në objektiva afatshkurtër, përkundër përpjekjeve për të arritur vlera të larta të aksioneve në afat të gjatë.
- Harmonizimi i interesave të pronarëve dhe agjentëve, duke kushtëzuar kompensimin e menaxherëve me performancën afatgjatë të kompanisë dhe vlerësimin e saj financiar, dhe/ose duke emetuar aksione me opsion për menaxherët.
- Kontrolli i besueshmërisë së raporteve financiare që përgatitin menaxherët, nga auditorë të brendshëm dhe ekspertë kontabël të certifikuar.
- Hartimi dhe zbatimi i një sistemi të brendshëm kontrolli efektiv, që konsiston në politika, procedura dhe teknologjinë

[1] Një sipërmarrje armiqësore konsiston në pajtimin e disa aksionerëve dhe investitorëve të jashtëm për të blerë aksione dhe për t'u bashkuar, duke krijuar shumicë në mbledhjen e aksionerëve edhe votuar një ekip tjetër drejtues.

e duhur për të siguruar besueshmërinë e raporteve financiare, respektimin e ligjit dhe të rregulloreve, si dhe efektshmërinë e eficiencën e operacioneve.

2.2.2 TEORIA E AKTORËVE TË INTERESUAR

Siç u diskutua dhe më lart, teoria e agjencisë bazohet në të drejtën ligjore dhe morale të aksionerëve për të mbikëqyrur kompaninë, mbi të cilën gëzojnë pretendime ligjore në lidhje me flukset e mbetura dhe të drejtat e pronësisë. Vështruar në një nivel tjetër, teoria e aktorëve (*stakeholders theory*) kërkon që menaxherët t'u japin llogari jo vetëm aksionerëve por edhe aktorëve të tjerë të përfshirë (*stakeholders*). Ky arsyetim bazohet në argumentin se përveç aksionerëve, "interes" mbi kompaninë kanë edhe subjekte të tjera për aq kohë sa ata ndikohen nga veprimtaria e saj. Këta aktorë mund të jenë punonjësit e kompanisë, komuniteti, kreditorët dhe klientët e saj. Solomon (2010) thekson se në disa qasje ekstreme të kësaj teorie, grupi i aktorëve të interesuar mund të përfshijë mjedisin, specie kafshësh ashtu si dhe brezat e ardhshëm. Megjithatë, kriteri mbizotërues për klasifikimin e aktorëve është steka legjitime e interesit që këto subjekte kanë mbi kompaninë. Kjo teori gjen më shumë zbatim në rastin e kompanive të mëdha, të cilat kanë ndikim të konsiderueshëm jo vetëm mbi një grup të ngushtë të shoqërisë, siç janë aksionerët, por edhe mbi një grup më të gjerë të saj.

Teoria e aktorëve gjen zbatim në vendet perëndimore të Evropës kontinentale, më tradicionalisht në Francë dhe Gjermani, ku punonjësit si aktorë të interesuar kanë një zë të rëndësishëm në drejtimin e kompanisë. Në këto vende, përfaqësuesit e punonjësve janë pjesë e anëtarësisë së këshillit drejtues ose punonjësit zotërojnë aksione të kompanisë. Në këtë mënyrë, ata ndikojnë mbi politikat, strategjitë dhe drejtimin e përditshëm të saj, nëpërmjet ushtrimit të të drejtës së votës.

Në këtë këndvështrim, përgjegjësia shoqërore e korporatës – një çështje e lidhur ngushtë me teorinë e aktorëve - po kthehet në një instrument kyç në fitimin dhe ruajtjen e besimit të tregut në

kompani. Përkrah vetëndërgjegjësimit të kompanive dhe vetëdijes shoqërore si elemente kyçe të motivimit të kompanive për të përqafuar përgjegjësinë shoqërore, mjedisi social dhe politik po i shtyn gjithashtu bizneset që të jenë më të përgjegjshme ndaj komuniteteve dhe aktorëve të tjerë të interesuar.

Teoria e aktorëve duket se është në konflikt me themelet e teorisë së agjencisë. Pyetja kryesore që lind është: A munden kompanitë që në të njëjtën kohë të kënaqin interesat e aksionerëve duke plotësuar edhe nevojat e aktorëve të tjerë të interesuar? Sipas teorisë së agjencisë, drejtuesit mund t'i japin llogari një game të gjerë aktorësh, por përgjegjësia e tyre parësore është të përmbushin interesat e aksionerëve (*Goodpaster*, 1991). Megjithatë në dritën e krahasimit cilësor të dy teorive, Smerdon (2010) argumenton se edhe në vendet ku teoria e aktorëve është një dimension kyç i të bërit biznes, skandalet financiare kanë qenë të pranishme dhe të shkaktuara nga dështime të ngjashme me ato në Mbretërinë e Bashkuar apo SHBA, vende nga të cilat teoria e agjencisë ka buruar dhe është zhvilluar.

Pavarësisht dallimeve në dukje diametrike, në terma praktikë, ndryshimet themelore midis këtyre dy teorive po bëhen më të zbehta. Kompanitë po i kushtojnë gjithmonë e më shumë vëmendje përgjegjësisë shoqërore edhe në vende si Mbretëria e Bashkuar dhe Shtetet e Bashkuara, duke e konsideruar atë si mbështetëse të qëndrueshmërisë afatgjatë. Kjo qasje, e quajtur "vlera e zbutur e aksionerit" (*enlightened shareholder value*) është bërë objekt i akteve ligjore që përcaktojnë parimet e qeverisjes së kompanive (Smerdon 2010, f. 23-24).

2.2.3 MODELET E NDIKUESVE TË JASHTËM DHE TË BRENDSHËM NË QEVERISJEN E KORPORATAVE

Ndërsa teoritë për qeverisjen e korporatave përqendrohen në detyrimin e besnikërisë të menaxherëve ndaj aksionerëve (teoria e agjencisë) apo ndaj një grupi më të gjerë aktorësh (teoria e aktorëve), studimet mbi sistemet e qeverisjes së korporatave në botë thellohen edhe më tej duke analizuar kulturën, sistemet financiare dhe ligjore, si dhe sfondin historik të vendit.

Modelet e trajtuara më gjerësisht në lidhje me qeverisjen e korporatave janë modelet e ndikuesve "të jashtëm" dhe atyre "të brendshëm", ku Mbretëria e Bashkuar dhe SHBA-ja janë subjektet më përfaqësuese të studimit, dhe vende të tjera me sisteme financiare dhe ligjore të ngjashme (të jashtme), si dhe Gjermania e Japonia (të brendshme). Literatura aktuale për kategorizimin e këtyre dy sistemeve, identifikon kritere të ndryshme, por të ndërlidhura me njëra - tjetrën.

Shleifer dhe Vishny (1997) në një prej studimeve më të plota për qeverisjen e korporatave, nënvijëzojnë se përqendrimin e pronësisë së kompanive dhe ndikimin i sistemit ligjor duke vënë theksin në nivelin e mbrojtjes ligjore të të drejtave pasurore të investitorëve. Solomon (2010) identifikon përqendrimin e pronësisë dhe burimet financiare të kompanisë si kriter më të rëndësishëm, ndërsa Stephen dhe Backhouse (2003, f. 393) i shohin këto dy modele si "rregullime institucionale me anë të të cilave kontrollohet sjellja menaxheriale".

Sistemi i ndikimit "të jashtëm" në qeverisjen e korporatave

Sistemi i ndikimit të jashtëm, i njohur në literaturë edhe si sistemi në bazë tregu, është formësuar në vende me tregje shumë të zhvilluara të kapitalit. Tregjet e kapitalit në këto vende janë burimi parësor i financimit për kompanitë. Vendet më përfaqësuese, të këtij sistemi janë Mbretëria e Bashkuar dhe SHBA-ja, ku pronësia e bankave mbi stokun e kapitalit në kompani jobanka në përgjithësi është e ndaluar. Ky sistem njihet si modeli anglo-amerikan apo anglo-sakson, ndërtuar mbi parimin e pronësisë së kompanisë të ndarë nga kontrolli i përditshëm mbi të. Siç u shpjegua më parë, teoria e agjencisë dhe zgjidhjet e problemeve në lidhje me këtë ndarje lindin në këtë sistem të qeverisjes së korporatave. Tregjet e zhvilluara të titujve në këto vende shërbejnë për gjenerimin e të ardhurave nga investitorët institucionalë nëpërmjet tregtimit të aksioneve. Dy efekte kryesore të këtij sistemi janë: përqendrimi i kufizuar i pronësisë, dhe krijimi i një mekanizimi disiplinor për menaxherët bazuar tek stimujt. Ndonëse relativisht pozitiv, efekti i parë i sistemit mund të dekurajojë qeverisjen e shëndoshë të

korporatave, meqenëse në rast mosmarrëveshjeje me menaxherët, investitorët mund të parapëlqejnë t'i shesin aksionet sesa të mbartin kosto shtesë nga nxitja e një qeverisjeje më të mirë. Kjo është e zakonshme, në mënyrë tipike, te investitorët e vegjël si individë të karakterizuar nga sjellja pasive (*free-riding*). Efekti i dytë mbështetet në dukuri që janë tipike për tregjet e aksioneve, të tilla si sipërmarrjet armiqësore (*hostile takeover*). Zakonisht performanca e ulët e menaxherëve në administrimin e kompanisë ndikon në vlerën e tregut të aksioneve, çka josh investitorët e mëdhenj për të blerë kompani duke ushtruar presion mbi to. Qëllimi i këtyre investitorëve është gjenerimi i të ardhurave nga rritja e vlerës së aksioneve të kompanisë në treg nëpërmjet menaxhimit më të mirë të saj (Stephen dhe Backhaus, 2003). Sipërmarrja armiqësore (*hostile takeover*) mund të sjellë edhe efekte të kundërta. Për shembull, për ta shmangur atë, menaxherët priren të angazhohen në strategji afatshkurtra për të siguruar kthim të lartë nga kapitali, por nga ana tjetër në dëm të ecurisë afatgjatë të kompanisë.

Një veçori tjetër e këtij modeli është niveli i lartë i transparencës në tregun e kapitaleve, e nxitur nga kërkesa të forta ligjore që kanë për qëllim mbrojtjen e interesave të investitorëve nga sjellja abuzive e menaxherëve (Cioffi, 2003). Shleifer dhe Vishny (1997) argumentojnë se niveli më i lartë i mbrojtjes ligjore të investitorëve, në krahasim me atë të krediduesve është veçori tipike dhe dalluese e modelit të jashtëm. Në vendet që kanë sistemin e ndikimit të brendshëm, kredia bankare është burimi më i rëndësishëm i financimit për kompanitë, pasi vlerësimi i investimit është më i lehtë nëpërmjet kolateralit të trupëzuar. Gjithashtu më i lehtë është edhe vërtetimi dhe provimi i mospërmbushjes së detyrimeve kontraktore përpara gjykatës. Përveç sa më sipër, ky lloj sistemi siguron një mënyrë më të sigurtë për kthimin e investimit nëpërmjet ekzekutimit të kolateralit. Megjithatë kjo e fundit është e mundur në vendet me një kuadër të fortë dhe efektiv ligjor për ekzekutimin e kolateralit në kohën e duhur (Shleifler dhe Vishny 1997).

Sistemi i ndikimit "të brendshëm" në qeverisjen e korporatave

Sistemi i ndikimit të brendshëm karakterizohet nga pronësia e përqendruar dhe kontrolli i ushtruar mbi kompaninë nga një numër

i vogël aksionerësh të mëdhenj. Në këto sisteme, kompanitë janë: të zotëruara nga familje që i kanë themeluar ato apo grupe të tjera aksionerësh si qeveritë; kompani të vogla të ndërlidhura me njëra-tjetrën nëpërmjet zotërimit të kryqëzuar të aksioneve (*cross-shareholding*) dhe strukturave të pronësisë të formës piramidë (Solomon, 2010). Si pasojë e tregjeve jo të zhvilluara të kapitalit, në vendet ku mbizotëron ky sistem nuk ekzistojnë mekanizmat kontrollues të tregut mbi korporatën me anë të sipërmarrjeve armiqësore (Stephen dhe Backhouse 2003). Për më tej, është e vështirë që këto sipërmarrje të ndodhin për shkak të strukturës tejet të përqendruar të pronësisë (Cioffi, 2003). Në dallim nga sistemi i ndikimit "të jashtëm", financimi i aktivitetit të kompanisë përgjithësisht kryhet jo nëpërmjet kapitalit aksioner, por nëpërmjet financimit të brendshëm nga anëtarët e strukturave me pjesëmarrje të kryqëzuar në kapital ose nëpërmjet kredive bankare.

Cioffi (2003) e përkufizon sistemin financiar gjerman si "[...] të përqendruar në banka, të përcaktuar nga legjislacioni i cili i dizenjon kompanitë si një subjekt i madh vetërregullues, brenda një ekonomie sociale të tregut e bazuar në konsensus, me përfaqësimin e vet të interesit neo-korporatist, marrëveshje e përqendruar e pagës dhe një rrjet të ndërlidhur, të financave dhe pronësisë korporative "(f. 7), i cili ka çuar në përqasjen sipas teorisë së aktorëve të interesuar. Sipas Miawa dhe Ramseyer (2000, f. 403), sistemi i ndikimit të brendshëm në Japoni është i dizenjuar sipas kulturës japoneze, në trajtën e grupeve të korporatës (*keiretsu*) me "bankën kryesore" në qendër të grupit. Ashtu si në Gjermani, edhe në sistemin japonez, ndarja e informacionit ndodh nëpërmjet *keiretsu*-t, pjesëmarrjes së kryqëzuar në kapital ku menaxherët nuk u duhet të përballen me presionin e mekanizmave kontrollues të tregut të kapitalit, por janë përgjegjës dhe japin llogari ndaj "bankës kryesore". Kjo e fundit ushtron autoritet monitorues ndaj kompanive kliente (anëtare të grupit) dhe kontroll mbi anëtarët me performancë të dobët, shpesh përmes të ashtuquajturës "ndihmë të shpëtimit" (*bailout*) (Stephen dhe Backhaus 2003, f. 394).

Bankat duke zotëruar sasi domethënëse të aksioneve të klientëve të tyre - depozitues të mëdhenj (biznese), ushtrojnë mbikëqyrje të fortë ndaj tyre nëpërmjet informacionit të brendshëm, çfarë

shmang, problemin e agjencisë nga asimetria e informacionit. Po ashtu, mbikëqyrja nga brenda e menaxhimit, e bën më të lehtë harmonizimin e interesave të menaxherëve dhe të aksionerëve nga njëra anë, dhe ngushton largësinë midis pronësisë dhe kontrollit real mbi kompaninë nga ana tjetër. Për rrjedhojë, zbehja e ndarjes midis pronësisë dhe kontrollit mund të kthehet në dëm të aksionerëve të pakicës, të cilët duke mos qenë në pozicionin e "bankës kryesore" nuk janë në gjendje të marrin informacion për operacionet e kompanisë. Një fenomen i tillë është i pranishëm në vendet e Azisë Lindore, ku sistemet e qeverisjes së korporatave janë më pranë modelit të ndikimit të brendshëm. Ai karakterizohet nga mbrojtje e dobët ligjore për aksionerët e pakicës - faktor që është identifikuar si një prej shkaqeve të krizës financiare aziatike në vitin 1997 (Classens dhe Fan 2002, Solomon 2010).

Në Gjermani, sistemi i ndikimit të brendshëm, i quajtur edhe modeli me dy nivele i këshillit, konsiderohet si një prej kontribuesve kryesorë të performancës së lartë ekonomike të vendit, në periudhën e pas Luftës së Dytë Botërore. Madje, është konsideruar si një model më efektiv dhe më eficient se sa sistemi i ndikimit të jashtëm, sa i takon eliminimit të problemeve të agjencisë dhe nxitjes së qëndrueshmërisë afatgjatë. Tabela 2.1 paraqet një përmbledhje krahasuese të veçorive të dy këtyre dy sistemeve të qeverisjes së korporatave.

Tabelë 2.1 Tabelë krahasuese e sistemit të ndikimit të brendshëm dhe atij të jashtëm

Sistemi i ndikimit "të jashtëm" i qeverisjes së korporatave	Sistemi i ndikimit "të brendshëm" i qeverisjes së korporatave
Pronësia e shpërndarë e zotëruar nga aksionerë të jashtëm	Pronësia e përqendruar në aksionerë të brendshëm (zakonisht anëtarë të familjeve themeluese, qeveri dhe kompani me anë të pjesëmarrjes së kryqëzuar të kapitalit dhe strukturave piramidë të pronësisë)
Pronësi e ndarë nga kontrolli i ushtruar drejtpërdrejt nga menaxherët mbi kompaninë, çfarë gjeneron problemin e agjencisë	Ndarje jo e qartë e pronësisë nga kontrolli mbi kompaninë dhe me probleme të rralla të agjencisë
Sjellja menaxheriale e disiplinuar nga sipërmarrjet armiqësore	Sjellja menaxheriale e monitoruar dhe kontrolluar nga aksionerët e brendshëm dhe sipërmarrjet armiqësore
Aksionerët parapëlqejnë "largimin" më shumë se "zërin"	Aksionerët e shumicës priren të kenë më shumë "zë" në drejtimin e kompanive ku investojnë
Aksionerët janë të orientuar më shumë në terma afatshkurtër se sa afatgjatë	Aksionerët e shumicës, duke qenë të brendshëm, sigurojnë strategji afatgjatë dhe qëndrueshmëri të kompanisë
Tregje financiare të zhvilluara dhe të sofistikuara	Nivel i ulët i sofistikimit dhe diversifikimit të tregut financiar
Kapitali aksioner është burimi kryesor i financimit i shprehur në raport të ulët borxh/kapital aksioner si dhe në raport të ulët hua bankare/detyrime gjithsej	Financimi brenda grupit/familjes dhe huatë bankare të shprehura në raport të lartë borxh/kapital aksioner dhe në raport të lartë hua bankare/detyrime gjithsej
Mbrojtje e fortë ligjore e interesave të investitorëve (zbatim dhe forcim i transparencës dhe të drejtës mbi pronësinë)	Mbrojtje e dobët ligjore për interesat e investitorëve
Potencial për demokraci mes aksionerëve	Potencial për shfrytëzim/abuzim të aksionerëve të pakicës
Nuk ka transferim të pasurisë nga aksionerët e pakicës drejt atyre të shumicës	Transferim i pasurisë nga aksionerë të pakicës drejt atyre të shumicës

Burimi: Solomon (2010, f. 196) dhe Stephen dhe Backhouse (2003, f. 394).

2.2.4 KONVERGIMI I SISTEMEVE

Zhvillimi i tregut financiar botëror është shoqëruar me prirjen drejt konvergimit të sistemeve të qeverisjes së korporatave të vendeve të ndryshme.

Në Mbretërinë e Bashkuar dhe në SHBA, institucione të mëdha financiare po kthehen në aksionerë gjithmonë e më të mëdhenj, duke ndryshuar strukturën e shpërndarë të kapitalit të kompanive.

Kjo sjell rritjen e monitorimit të sjelljes menaxheriale - veçori kjo, dalluese e sistemit të ndikimit të brendshëm (Solomon, J. 2010).

Nga ana tjetër, për kompanitë gjermane, tiparet e modelit të ndikimit të brendshëm duket se janë kthyer në barriera për gjenerimin e financimit të aktivitetit në tregjet financiare ndërkombëtare. Sipas Solomon (2010), reformat e dhjetëvjeçarëve të fundit, si për shembull forcimi dhe përmirësimi i transparencës dhe adoptimi i standardeve ndërkombëtare të pranuara gjerësisht për qeverisjen e korporatave, kanë çuar në zbehjen e sistemit të ndikimit të brendshëm në Gjermani drejt konvergimit me sistemin e ndikimit të jashtëm.

2.3 QEVERISJA E KORPORATAVE NË BANKA

Në kontrast me literaturën relativisht të pasur për qeverisjen e korporatave në përgjithësi, deri në krizën e fundit financiare të viteve 2007-2009, qeverisjes së korporatave në banka i është kushtuar pak vëmendje nga akademikët. Si një prej shkaqeve të dështimit të bankave, kriza identifikoi ndër të tjera edhe qeverisjen e dobët të korporatave. Kirkpatrick (2009), i kontraktuar nga OECD-ja, një prej organizatave ndërkombëtare me ndikimin më të madh që studion zhvillimet e qeverisjes së korporatave, identifikoi si dobësi: kërkesat e pamjaftueshme të standardeve rregullatore dhe të kontabilitetit; administrimin e dobët të rrezikut; mosharmonizimin e politikave të remunerimit me strategjinë e institucioneve financiare, oreksin për rrezik, dhe interesat afatgjatë të tyre. Autorë të tjerë vënë theksin në problematika të tjera të qeverisjes së korporatave, të tilla si: sjellja etike dhe veprimet apo mosveprimet oportuniste të këshillit drejtues dhe të menaxhimit të lartë në institucione financiare (Solomon 2010, Clarke dhe Klettner 2010). Megjithatë, Műlbert (2009) dhe Kirkpatrick (2009) argumentojnë se nuk ka të dhëna për një kazualitet të drejtëpërdrejtë midis dështimeve në qeverisje dhe krizës. Műlbert (2009) argumenton se as të dhënat e shumta jozyrtare nuk mund të konsiderohen si provë e fortë për të vërtetuar se shkaku kryesor i krizës ishin dështimet në qeverisjen e korporatave. Gjithsesi, pamundësia për të provuar kazualitet me domethënie të sigurt, nuk e zbeh efektin e dështimeve në qeverisje

në përkeqësimin e krizës si dhe nevojën për reforma që përmirësojnë në disa fusha specifike qeverisjen e korporatave në banka. Nisur nga kjo, është pranuar gjerësisht se dështimet e qeverisjes dhe mangësitë e sistemit rregullator, nëse nuk i lehtësuan, të paktën nuk i kanë penguar praktikat që shkaktuan trazirat financiare në sektorin bankar (Kirkpatrick 2009, Műlbert 2009, Walker 2009).

Për të ndërtuar bazat teorike të analizës sonë të qeverisjes në sistemin bankar shqiptar, fillimisht do të analizojmë veçoritë e bankave, rregullimin bankar, rolin e rregullatorëve dhe mbikëqyrësve dhe mënyrën si ndikojnë ata qeverisjen e bankave.

2.3.1 DALLIMET E BANKAVE NGA KOMPANITË E TJERA

Në dallim nga kompanitë e zakonshme, bankat kanë një rol të veçantë në shoqëri. Atyre u besohet ruajtja e kursimeve. Në ekonomitë me tregje të pazhvilluara të kapitalit, bankat kanë edhe funksionin kryesor të rishpërndarjes së burimeve financiare në projekte produktive investimi. Përveç kësaj, struktura e kapitalit të bankave paraqitet në bilancet e tyre financiare në një mënyrë të veçantë; ato dhe partneritetet e tyre të biznesit, kanë rëndësi sistemike dhe si të tilla rregullohen shumë më ndryshe nga pjesa tjetër e kompanive fitimprurëse. Rregullimi i bankave, siç shprehen Cinancianelli dhe Gonzales (2000, f.6), "është një element intrigues, pasi ekzistenca e rregullimit mund të konsiderohet ose rezultat i natyrës së veçantë të bankave, ose si veçori që i dallon ato nga kompani të tjera publike të listuara."

Në këndvështrimin tonë, të dyja pikëpamjet meritojnë të diskutohen.

2.3.2 ASPEKTE TË RËNDËSISHME TË STRUKTURËS SË KAPITALIT TË BANKAVE

(i) *Struktura e kapitalit*. Një veçori specifike e bankave, e rrënjosur si në anën e pasiveve edhe në atë të aktiveve të bilancit, është mospërputhja midis maturitetit të tyre (Műlbert 2003, Macey, dhe O'Hara 2003). Në ndryshim nga kompanitë e zakonshme, të cilat e financojnë veprimtarinë e tyre më shumë me kapital aksioner se

sa me hua, si një rast tepër unik, raporti hua/kapitali aksioner në banka, është në kah të kundërt. Aksionerët e bankave sigurojnë vetëm rreth 10% të financimit. Pjesa e tjetër e tij gjenerohet kryesisht me borxh, kryesisht në trajtën e depozitave të ripagueshme me kërkesë të depozituesit. Nga ana tjetër, aktivet janë tipikisht kreditë bankare me maturitet më të gjatë se ai i depozitave. Për këtë arsye, veprimtaria bazë e bankave mbështetet në këtë mospërputhje të afateve të maturiteteve, duke i mundësuar të nxjerrin fitime, në trajtën e primeve nga kreditë (me norma interesi më të larta se ato të depozitave). Nga ky këndvështrim, bankat kanë funksionin e sigurimit të likuiditetit, i cili varet në mënyrë të konsiderueshme nga fluksi i vazhdueshëm i tij. Likuiditeti gjenerohet nga depozitat dhe huatë në tregun ndërbankar, financimi nga tregje shumë të sigurta financiare, dhe në rast vështirësie nga bankat qendrore, me anë të instrumentit të huadhënësit të fundit (*lender of last resort*) (Műlbert).

(ii) Rrjedhja e depozitave (bank runs). Kjo është një dukuri e lidhur ngushtë me mospërputhjen e afateve të maturimit dhe funksionit të sigurimit të likuiditetit. Bankat japin kredi nga fondet e gjeneruara nga kreditorët e saj (depozituesit/huamarrësit), duke mbajtur si rezerva vetëm një sasi të kufizuar të tyre. Në rastin e rrjedhjes së depozitave, këto rezerva shterohen jashtëzakonisht shpejt si pasojë e tërheqjes masive të depozitave, duke i lënë bankat në pamundësi për të përmbushur njëkohësisht kërkesat e të gjithë kreditorëve të saj (depozituesve). Rrjedhja e depozitave konsiderohet si 'dilema klasike e të burgosurit' për kreditorët, të cilët nuk mund të bashkërendojnë dot në mënyrë racionale veprimet e tyre për t'u përmbajtur nga tërheqja e njëkohëshme e depozitave të tyre, çfarë nuk kursen nga falimentimi qoftë edhe një bankë me aftësi paguese (Műlbert, 2003, Macey dhe O'Hara 2003).

(iii) Paqartësia e bilanceve të bankave. Përgjithësisht, shkalla e rrezikut të aktiveve të patrupëzuara është më e vështirë të vlerësohet, si për shembull kreditë bankare, sesa ato të trupëzuara, siç janë inventarët, stabilimentet dhe makineritë. Sipas Műlbert, (2003), matja e cilësisë së aktiveve të bankës është e ndërlikuar, madje edhe për banka të tjera që zotërojnë ekspertizën e duhur, siç ilustrohet nga ngjarjet që pasuan rënien e Lehman Brothers.

(iv) Si tregohet nga Mülbert (2003), një tjetër veçori specifike e bankave është ndryshueshmëria e profilit të rrezikut, edhe në rastin kur pozicionet e investimit të tyre nuk ndryshojnë. Kjo ndodh kur bankat mbajnë portofole të konsiderueshme të instrumenteve derivative, të cilët janë shumë të ndjeshëm ndaj kushteve të jashtme të tregut.

(v) Në sistemet e zhvilluara bankare, tregjet ndërbankare, valutore dhe tregjet mbi banak (*Over the Counter Trade*) të derivativave janë burime të rëndësishme financimi, përkrah depozitave nga publiku. Bankat tregtojnë me njëra-tjetrën duke vepruar njëkohësisht edhe si konkurrentë edhe si kundërpalë, për këtë arsye, ato janë të ekspozuara ndaj rrezikut të njëra- tjetrës. Kjo ndërlidhje midis bankave krijon një mekanizëm të përsosur për transmetimin e shpejtë të problemeve financiare të një banke në të gjithë sistemin dhe, për rrjedhojë, në të gjithë ekonominë. Rëndësia sistemike e bankave për stabilitetin financiar i bën ato subjekte të rregullimit dhe mbikëqyrjes nga agjenci shtetërore, të cilat përfaqësojnë dhe mbrojnë interesin publik (Ciancianelli dhe Gonzales, 2000).

2.3.3 PROBLEMET E AGJENCISË SPECIFIKE PËR BANKAT

Karakteristikat specifike të bankave, të shpjeguara më sipër, tregojnë se problemet e agjencisë në kompanitë – banka janë të një natyre tjetër. Duke qenë se ekziston një palë e tretë - entiteti rregullator dhe rregullimi bankar, të cilat i shërbejnë interesit të publikut, marrëdhëniet e agjencisë ndikohen prej tyre. Ciancianelli dhe Gonzales (2000) argumentojnë se si pasojë e rregullimit, problemi i agjencisë në banka është më kompleks. Autorët identifikojnë (2000, f. 6) "tri asimetri të tjera informacioni te bankat: (i) midis depozituesve, bankës dhe rregullatorit; (ii) midis pronarit, menaxherëve dhe rregullatorit; (iii) midis huamarrësve, menaxherëve dhe rregullatorit". Kjo do të thotë se qeverisja e bankave është substancialisht ndryshe nga qeverisja e korporatave të zakonshme.

Roli i rregullatorit mund të shpjegohet si një forcë e jashtme shtesë, që ndikon qeverisjen e bankave. Kjo do të thotë se bankat i shërbejnë jo vetëm interesit privat të aksionerëve, por edhe interesit të rregullatorit, i cili vepron si agjent për aktorë të tjerë të interesuar, në këtë rast, për publikun e gjerë. Rrjedhimisht, mund të nxjerrim përfundimin se bankat janë subjekte që i përshtaten më mirë teorisë së aktorëve.

Përveç sa më sipër, agjentët në një bankë (menaxherët) të cilët janë subjekt i kontrollit nga rregullatori, janë nën presion për të përmbushur nga njëra anë një grup interesash (të principalëve) pa kompromentuar nga ana tjetër interesat e rregullatorit. Ky pozicion i agjentëve të bankave imponon një sjellje të ndryshme menaxheriale nga ajo e agjentëve të kompanive të tjera (Ciancianelli dhe Gonzales, 2000).

Përcaktues të tjerë të rëndësishëm të formës së qeverisjes së bankave janë edhe instrumentet e politikave rregullatore për parandalimin e rrezikut sistemik, të tilla si huadhënësi i fundit (*lender of last resort*), sigurimi i depozitave dhe politika mbi konkurrencën (Ciancianelli dhe Gonzales, 2000).

Mundësia e rregullatorit për të përdorur instrumentin e huadhënësit të fundit (*lender of last resort*) do të thotë se pronarët e bankave, në ndryshim nga pronarët e kompanive të tjera, e ndajnë rrezikun me rregullatorin. Siguria që jep ndihma me anë të këtij instrumenti për shpëtim në rast falimentimi, lë hapësirë për krijimin e stimulit për të ndërmarrë rrezik më të madh se sa një kompani normale që nuk e ka këtë mundësi. Ciancianelli dhe Gonzales (2000) argumentojnë se meqenëse menaxherët monitorohen si nga këshilli edhe nga aktori mbikëqyrës i jashtëm, mundësia e huadhënësit të fundit, në të vërtetë, nxit aksionerët dhe jo menaxherët, për të ndërmarrë rreziqe më të mëdha. Ndonëse ky arsyetim mund të mos gjejë vend drejtpërdrejt në krizën e fundit dhe ndihmat për shpëtim që iu akorduan institucioneve financiare perëndimore, shqetësimi që ngrenë autorët është i qenësishëm për ekonomitë në tranzicion, si Shqipëria, ku banka mëmë të mëdha perëndimore kanë shumicën e aksioneve në bankat që veprojnë në vend.

Në lidhje me 'sigurimin e depozitave', tashmë është vërtetuar se është një instrument që parandalon rrjedhjen masive të depozitave nga bankat. Megjithatë, për shkak se në një mënyrë është sigurim i pakushtëzuar për bankat, sigurimi i depozitave mund të ketë efekt të kundërt mbi qeverisjen e mirë të tyre. Ashtu si në rastin e huadhënësit të fundit, edhe "sigurimi i depozitave" rrit stimulin e principalëve dhe agjentëve për të ndërmarrë rrezik shtesë (Macey dhe O'Hara 2003). Gjithashtu, sigurimi i depozitave mund të çlirojë depozituesit nga interesi për të monitoruar përdorimin e fondeve të tyre nga bankat. Nga ana tjetër, Mu" lbert (2009) argumenton se ky arsyetim, praktikisht, gjen zbatim më shumë për depozituesit e mëdhenj që zotërojnë njohuri dhe ekspertizë mbi rreziqet e bankingut dhe jo aq për depozituesit e vegjël.

Për shkak të veçorive të bankave si subjekte financiare të trajtuara më lart, konkurrenca e pakufizuar brenda sektorit mund të ketë pasoja të kundërta mbi qëndrueshmërinë/shëndetin e sistemit bankar. Konkurrenca agresive në rastin e sektorit bankar, mund të çojë në shtimin e oreksit si të aksionerëve ashtu edhe të menaxherëve për të marrë rrezik, përtej pritjeve prudenciale të rregullatorëve/mbikëqyrësve. Siç shprehen Ciancianelli dhe Gonzales (2000, f. 13, 21) "[...] rregullimi që synon korrigjimin e dështimeve të tregut dhe administrimin e rrezikut sistemik, ndikon mbi strukturën dhe veçoritë e konkurrencës brenda sektorit bankar". Kufizimet për hyrjen në treg, kërkesat për kapital, kontrolli '*fit-and-proper*' i punësimit të menaxherëve dhe veprimtaria mbikëqyrëse, nëse janë efektive, krijojnë kufizime në konkurrencë dhe për rrjedhojë ndikojnë qeverisjen e bankave (Shull et al, 2007, Ciancianelli dhe Gonzales 2000). Megjithatë, kjo nuk do të thotë se në sektorin bankar nuk ka konkurrencë. Ndërkohë që derregullimi financiar i parakrizës vazhdonte të vepronte, bankat ofruan shërbime bankare me çmime tregu. Megjithatë për shkak të kufizimeve rregullatore mbi konkurrencën, bankat nuk u përballën me presionin e saj ashtu si kompanitë e tjera. Presioni i kufizuar i konkurrencës mbi qeverisjen në sektorin bankar, krijoi një "mangësi thelbësore për qeverisjen" e cila u anashkalua gjatë procesit të derregullimit (Ciancianelli dhe Gonzales 2000, f. 19).

2.4 LIDHJA MIDIS QEVERISJES SË KORPORATAVE DHE RREGULLIMIT

Si qeverisja e korporatave edhe rregullimi bankar mund të shihen si rezultate të problemeve të agjencisë, të lidhura me ndarjen midis pronësisë dhe kontrollit të përditshëm mbi kompaninë (menaxhimit). Nga kjo pikëpamje ashtu si në rastin e qeverisjes së korporatave, objekti i rregullimit bankar është parandalimi i sjelljes abuzive të menaxherëve dhe i vendosjes së interesave të tyre vetjake mbi ato të principalëve, çfarë shkakton lindjen e konfliktit të interesave. Trajtimi i problemeve të së njëjtës natyrë, dhe përdorimi i instrumenteve të ngjashme për të arritur rezultatin e kërkuar, shkakton mbivendosje të qeverisjes së korporatave dhe rregullimit bankar (Shull, B et al, 2007). Műlbert (2009) argumenton se kjo marrëdhënie funksionale duhet të shihet më shumë si zëvendësuese ose plotësuese sesa si mbivendosëse në kuptimin e ngushtë. Caruana (2005, f. 2), Menaxher i Përgjithshëm i *Bank for International Settlements*, përdor të njëjtin argument kur shprehet se "qeverisja e mirë e korporatave dhe veprimet e duhura mbikëqyrëse janë plotësuese të njëra-tjetrës". Ai shton se "në kushtet e një qeverisjeje të dobët të korporatave, rregullimi dhe mbikëqyrja bankare nuk do të ishin të efektshme". Qeverisja e shëndetshme luan një rol më të gjerë në rastin e bankave sesa në kompanitë e tjera. Kjo pasi në rastin e bankave ajo u shërben jo vetëm interesave të korporatës, por, duke ofruar mjedisin e duhur për menaxhim të shëndetshëm dhe prudent, u shërben edhe interesave të mbikëqyrësve/rregullatorit (*Banca d' Italia*, 2007).

Qasja plotësuese e qeverisjes së korporatave dhe rregullimit ka filluar të tërheqë më shumë vëmendje në procesin e derregullimit të shërbimeve financiare. Sikurse shprehet Shull et al (2007, f.4), rregullatorët supozohej që gjatë derregullimit të tërhiqeshin nga rregullimi i fortë, duke i lëshuar më shumë terren qeverisjes së mirë të korporatave, të nxitur nga presioni i forcave të jashtme dhe vetëkorrigjuese të tregut. Ciancianelli dhe Gonzales (2000) argumentojnë se ashtu si rregullimi edhe qeverisja e korporatave duhet të konsiderohen si forca të jashtme me ndikim në mënyra të ndryshme mbi pronarët dhe menaxherët e bankave. Ata shkojnë edhe më tej duke arsyetuar se "rregullimi dhe vetë rregullatorët

nuk i kanë kushtuar vëmendjen e duhur qeverisjes së korporatave si një burim endogjen i rrezikut sistemik" (Ciancianelli and Gonzales, 2000 f. 11).

2.5 REAGIMI NDËRKOMBËTAR NDAJ KRIZËS FINANCIARE PËR FORCIMIN E QEVERISJES SË KORPORATAVE NË BANKA

Kriza financiare globale e viteve 2007-2009 theksoi domosdoshmërinë për reagim të menjëhershëm për forcimin e qeverisjes së korporatave në sektorin bankar. Ideja kryesore ku bazoheshin këto veprimeve ishte se mbikëqyrësit/rregullatorët duhet ta përdorin qeverisjen e korporatave nisur nga këndvështrimi i stabilitetit financiar. Siç u shpjegua më lart, qeverisja e korporatave konsiderohet si instrument plotësues në rregullimin bankar që ndihmon në ruajtjen e besimit të publikut në sistemin bankar, duke qenë thelbësor për stabilitetin financiar dhe për të gjithë ekonominë (Bazel, 2010; EU Green Paper 2010).

2.5.1 KOMITETI I BAZELIT PËR MBIKËQYRJEN BANKARE

Më 16 mars 2010, Komiteti i Bazelit për Mbikëqyrjen Bankare nxori një draft të rishikuar të parimeve të qeverisjes së korporatave në organizatat bankare (drafti i parë në 2006-ën), si përgjigje ndaj dështimeve të qeverisjes së korporatave të analizuara në krizën e fundit. Drafti përfundimtar i parimeve të reja, i nxjerrë në tetor 2010, synon trajtimin e problemeve të tilla si mbikëqyrja e pamjaftueshme e menaxhimit të lartë nga Këshillat Drejtues, administrimi i pamjaftueshëm i rrezikut dhe struktura organizative e veprimtari bankare komplekse apo të komplikuara, e të panevojshme.

Qasja e Komitetit të Bazelit ka si pikënisje stabilitetin financiar, duke vënë fokusin e qeverisjes së bankave vetëm në proceset e brendshme, nga ku mund të veçojmë, funksionet e administrimit efektiv të rrezikut, kontrollit dhe përputhshmërisë, si dhe auditit. Në këtë drejtim, qeverisja "e jashtme" e imponuar nga forcat e tregut dhe roli i aksionerëve të bankave janë jashtë fokusit të parimeve

të reja. Në të vërtetë, nga këndvështrimi i mbikëqyrësit, qeverisja e shëndoshë e korporatave në banka, ashtu si praktikat e shëndosha të menaxhimit të biznesit, janë parakushte për një sistem mbikëqyrës eficient nga pikëpamja e kostove dhe u mundëson mbikëqyrësve të krijojnë më shumë besim në proceset e brendshme të bankave. Një veçori tjetër dalluese e qasjes së Komitetit të Bazelit nga këndvështrimi i mbikëqyrësit - aktor i interesuar me stabilitetin financiar, - është orientimi i qeverisjes së bankave drejt modelit të aktorëve. Sipas parimeve (Parimi 1, f. 23), gjatë ushtrimit të përgjegjësive, Bordi duhet të marrë parasysh jo vetëm interesat e aksionerëve por edhe interesat e depozituesve dhe aktorëve të tjerë.

2.5.2 QEVERISJA E KORPORATAVE NË BE

Komisioni Evropian e ka identifikuar qeverisjen e korporatave si një mjet të rëndësishëm për të gjeneruar kushtet e duhura për një treg financiar të brendshëm eficient në BE (*EC, Financial Services* 1999). Përfundimi kryesor i nxjerrë nga nisma të ndryshme të ndërmarra në këtë drejtim është se duke patur parasysh ndryshimet në sistemet ligjore dhe në ato financiare të shteteve anëtare, një kod i harmonizuar i BE-së për qeverisjen e korporatave nuk do të ishte i efektshëm. Përkundrazi, duhet inkurajuar një prirje në rritje drejt konvergimit të kodeve kombëtare të qeverisjes së mirë të korporatave.

Në përgjigje të krizës financiare globale, Komisioni Evropian publikoi më 3 qershor 2010 një material mbi qeverisjen e korporatave në institucione financiare dhe politikat e shpërblimit[2], i cili paraqet në vetvete një program për shqyrtimin e qeverisjes së korporatave në institucione financiare. Konteksti i përgjithshëm i qasjes së BE-së ndaj qeverisjes së korporatave në këto institucione është i ngjashëm me atë të Komitetit të Bazelit. Së pari, ai përqendrohet në kuptimin e ngushtë të qeverisjes së korporatave, duke mbuluar vetëm proceset e brendshme të menaxhimit të biznesit të bankave, dhe lë jashtë trajtimit aspekte të tjera të rëndësishme, si ndarja e

[2] *Green Paper on Corporate Governance in financial institutions and remuneration policies.*

qartë e përgjegjësive dhe funksioneve. Së dyti, ky dokument (*Green Paper*) përforcon këndvështrimin e mbikëqyrësve për qeverisjen e korporatave, duke theksuar rëndësinë që ka qeverisja e shëndoshë e korporatave në institucione financiare për mbrojten e interesave të kreditorëve (depozituesve) së bashku me ato të aksionerëve.

Nga ky këndvështrim, Autoriteti Evropian Bankar (EBA) - pasardhës i Komitetit Evropian të Mbikëqyrësve Bankarë (CEBS) - miratoi më 11 shtator 2011 udhëzimet për qeverisjen e brendshme[3]. Këto udhëzime, të mbështetura në përqasjen nga këndvështrimi i autoriteteve mbikëqyrësve, shkojnë edhe më tej; ato përkufizojnë një kuadër të ri e më të ngushtë të qeverisjes së korporatave - "qeverisjen e brendshme" të institucioneve financiare. Ato përcaktojnë (EBA, 2011) se: "[...] Qeverisja e korporatave është një koncept i gjerë që mund të përshkruhet si tërësi e marrëdhënieve midis një institucioni, menaxherëve, aksionerëve dhe aktorëve të tjerë. Qeverisja e brendshme është një pjesë përbërëse më e vogël por kyçe, e qeverisjes së korporatave, që fokusohet në strukturën e brendshme dhe në organizimin e një institucioni" (f. 9).

Me fjalë të tjera, rolet e auditorit të jashtëm, aksionerëve apo aktorëve të tjerë të jashtëm nuk janë në vëmendjen e këtyre udhëzimeve.

Udhëzimet sugjerojnë një model "mbrojtjeje në tri nivele" i cili duhet të zbatohet nga institucionet financiare. Ky model përfshin proceset e administrimit të rrezikut; kuadrin e kontrollit të brendshëm; dhe funksione kontrolli të tilla si, kontrolli i rrezikut, përputhshmëria dhe auditi i brendshëm.

Sipas Titullit I të udhëzimeve, objekt i rregullimit të tyre, është harmonizimi i pritshmërive mbikëqyrëse dhe përmirësimi i implementimit të shëndoshë të qeverisjes së brendshme në përputhje me nenin 22, Aneksin V të direktivës 2006/48/EC dhe ligjet kombëtare për kompanitë. Udhëzimet mund të zbatohen mbi baza të konsoliduara dhe të nënkonsoliduara si në institucione të vetme ashtu edhe në sipërmarrjet mëmë e filialet e tyre. Një tjetër veçori e qëllimit të udhëzimeve është parimi i proporcionalitetit,

[3] EBA Guidelines on Internal Governance (GL 44).

i cili në pamje të parë duket i ngjashëm me qasjen standarde "respekto" ose "shpjego" të kodeve të qeverisjes së mirë të korporatave. Në të vërtetë, ky parim, i parashikuar në direktivën 2006/48/EC nuk parashikon alternativën "shpjego". Përkundrazi, institucionit financiar i kërkohet të shpjegojë se si "[...] përqasja e tij për zbatimin e udhëzimeve, përmbush rezultatin e kërkuar, duke reflektuar natyrën, shkallën dhe kompleksitetin e veprimtarisë së institucionit" (EBA 2011, f.16). Në këndvështrimin tonë, ky parim nuk lë hapësirë për moszbatim nën qasjen "shpjego". Ai vetëm sa u jep institucioneve të drejtën për të zgjedhur mënyrën, instrumentet dhe mjetet sipas përmasës, veprimtarisë dhe kompleksitetit në lidhje me përmbushjen e kërkesave të udhëzimeve.

2.6 QEVERISJA E KORPORATAVE NË EKONOMITË NË TRANZICION

Problemet e qeverisjes së korporatave ekzistojnë në të gjitha vendet pavarësisht sistemit apo shkallës së zhvillimit të tyre. Megjithatë, në vendet në tranzicion, çështjet e qeverisjes së korporatave marrin rëndësi të veçantë. Në vendet post-komuniste pasojat e centralizimit të ekonomisë dhe jetës sociale duket se janë pengesa serioze për një qeverisje solide të korporatave.

Një prej karakteristikave të përbashkëta të këtyre vendeve janë tregjet e pazhvilluara financiare çfarë i bën bankat burimin kryesor të financimit dhe u jep rol kryesor për rritjen ekonomike (Arun dhe Turner, 2004). Një argument mund të ishte se bankat mund ta kenë marrë këtë rol falë zgjedhjes së vendeve për të përqafuar modelin e "ndikimit të brendshëm" të qeverisjes së korporatave, me dizenjimin e sistemeve të tyre të reja ligjore dhe ekonomike, gjatë periudhës së tranzicionit. Ndonëse argumenti i modelit të "ndikimit të brendshëm" në raste të veçanta ka të ngjarë të qëndrojë, ne mendojmë se faza e zhvillimit të tregjeve të kapitalit dhe forcimi i rolit të veçantë të bankave në këto vende është ndikuar më shumë nga sfidat e tranzicionit me të cilat janë përballur.

Mungesa e pronësisë private dhe 'monopoli' absolut i shtetit në periudhën e komunizmit, ka sjellë si pasojë nivele shumë të

ulëta të mbrojtjes ligjore të investitorëve në këto vende, sidomos të aksionerëve të pakicës. Sipas Shleifer dhe Vishny (1997) mbrojtja ligjore e investitorëve është parakusht për funksionimin e efektshëm të tregjeve të kapitalit, si një forcë e jashtme për qeverisjen e korporatave.

Në përgjithësi, vendet e *Common Law*, si Mbretëria e Bashkuar apo Shtetet e Bashkuara, ofrojnë mbrojtje të fortë ligjore për investitorët, ndaj dhe kanë tregje financiare të mirëzhvilluara (Shleifler and Vishny, 1997).

Pavarësisht nga sistemi ligjor, zbatimi efektiv i ligjit mbetet sfida më e madhe e përbashkët për vendet në tranzicion. Në një material mbi qeverisjen e korporatave në vendet e Evropës Juglindore (EJL)[4], OECD-ja identifikon kapacitetet e dobëta të sistemit gjyqësor në vendet e EJL-së si një nga pengesat kryesore për një qeverisje të efektshme të korporatave (OECD, 2003). Ndonëse reformat ligjore kanë sjellë akte ligjore të standardeve të larta, sistemet gjyqësore në këto vende janë gjendur të papërgatitura për shkak të mungesës së përvojës, mungesës së trajnimit të vazhdueshëm dhe burimeve të pamjaftueshme. Në të vërtetë, ekspertiza, profesionalizmi dhe burimet e pamjaftueshme, ndërthurur me një nivel të lartë korrupsioni dhe mungesën e pavarësisë të pushtetit gjyqësor, i përkeqësojnë më tej rezultatet negative të mungesës së "Sundimit të së Drejtës" (Barth, Caprio dhe Levine, 2002).

Përveç mbrojtjes së dobët të investitorëve, sidomos të aksionerëve të pakicës, pengesa të tjera për financimin e kapitalit janë edhe informacioni jo i besueshëm financiar si dhe kërkesat jo të forta ligjore për transparencë financiare (Arun dhe Turner, 2004). Për Shleifer dhe Vishny (1997), në vendet në tranzicion, huatë bankare mbeten mjete më të sigurta financimi sesa investimet kapitale, për arsye se huaja mbështetet me kolateral i cili është më i lehtë për t'u vlerësuar.

Arun dhe Turner (2004) i çojnë këto argumente edhe më tej duke arsyetuar se problemet potenciale në vendet në tranzicion shtohen edhe për shkak të përqendrimit të pronësisë. Së bashku me

[4] *White paper on Corporate Governance in South East Europe (SEE).*

ndarjen jo fort të qartë mes pronësisë dhe kontrollit (menaxhimit), përqendimi i lartë i pronësisë shkakton probleme shtesë të agjencisë në dëm të aksionerëve të pakicës. Përqendrimi i pronësisë është pasojë e drejtpërdrejtë ose e strukturave të pronësisë me baza familjare, ose e një procesi të ngadaltë privatizimi në ekonomitë në tranzicion.

Mungesa e tregjeve financiare sjell një sërë rezultatesh, ndër të cilat, veçohen si më të rëndësishmet dhe të drejtpërdrejta: numri i ulët i menaxherëve me ekspertizë në tregun e punës, anëtarë këshilli pa përvojë, ndikim politik në qeverisjen e kompanive me shumicë aksionesh dhe kontroll dominues të shtetit (Mc. Gee dhe Preobragenskaya, 2004).

Të gjitha veçoritë e lartpërmendura për ekonomitë në tranzicion shtyjnë drejt një modeli të "ndikimit të brendshëm" të qeverisjes së korporatave, pavarësisht sistemit të dizenjuar në përmbajtjen e legjislacionit (*letter of law*) (Shleifler and Vishny, 1997). Si rrjedhojë, bankat në këto vende duhet të përballen me një gamë të re problemesh të agjencisë, të cilat janë specifike për ekonomitë në tranzicion dhe që lindin nga marrëdhënia midis qeverisjes së korporatave dhe rregullimit bankar. Kjo nxjerr në pah domosdoshmërinë për një rol më të fortë të agjencive rregullatore dhe mbikëqyrëse, për arsye se si agjentë të interesit të publikut, që operojnë në një mjedis ku monitorimi i jashtëm privat dhe mekanizat kontrollues të tregut mungojnë, ato kanë më shumë incentivë se gjyqtarët për zbatimin dhe forcimimin e ligjeve dhe akteve nëligjore (OECD, 2003).

Mbështetur në këto baza teorike, synojmë të eksplorojmë mjedisin institucional dhe legjislativ të qeverisjes së korporatave të bankave në Shqipëri, me fokus kryesor mbi rolin e këshillit drejtues. Për këtë arsye, do të analizojmë përcaktimet ligjore dhe zbatimin e tyre në praktikë, për të identifikuar modelin e qeverisjes së korporatave të kompanive në përgjithësi dhe të bankave në veçanti.

3. QEVERISJA E KORPORATAVE NË SHQIPËRI

3.1 NJË MODEL PËR QEVERISJEN E KORPORATAVE PËR SHQIPËRINË

Në këtë seksion, do të përpiqemi të identifikojmë modelin e qeverisjes së korporatave që zbatohet në Shqipëri, duke analizuar kuadrin ligjor dhe disa probleme me të cilat përballet Shqipëria si një vend në tranzicion.

3.1.1 REFORMAT NË KUADRIN LIGJOR TË QEVERISJES SË KORPORATAVE

Shqipëria është vend në zhvillim[5], i cili vazhdon të ndërmarrë reforma strukturore, ekonomike, sociale dhe ligjore, kryesisht në kuadrin e procesit të integrimit të vendit në BE. Megjithatë, pavarësisht nga arritjet e deritanishme, vendi vazhdon të mbetet i ngecur në tranzicionin e gjatë që ka nisur që prej vitit 1992.

Në vitin 2003, Shqipëria filloi negociatat me Bashkimin Evropian për Marrëveshjen e Stabilizim - Asociimit (MSA)[6], e cila u nënshkrua në vitin 2005 dhe hyri në fuqi një vit më pas. MSA-ja shërben si instrument kalimtar (për një periudhë 10-vjeçare) me synim afrimin e Shqipërisë me standardet dhe vlerat e BE-së dhe për ta përgatitur vendin për anëtarësim në BE.

---

[5] Sipas metodologjisë së Bankës Botërore për klasifikimin e vendeve, shih *http://data.worldbank.org/country/albania*

[6] MSA-ja është një instrument kontraktual që përdoret për arritjen e objektivave të Procesit të Stabilizim-Asociimit. Shih OJ L 107, 28.04.2009. Sipas fjalorthit të Komisionit Evropian: "Procesi i Stabilizim-Asociimit (PSA) është politika e Bashkimit Evropian karshi Ballkanit Perëndimor, krijuar me qëllim integrimin evropian. Vendet e Ballkanit Perëndimor janë përfshirë në një partneritet progresiv me qëllim stabilizimin e rajonit dhe krijimin përfundimisht të një zone të tregtisë së lirë. PSA-ja përcakton qëllimet e përbashkëta politike dhe ekonomike, ndonëse vlerësimi i progresit mbështetet në meritat e secilit vend. Instrumentet kontraktore (Marrëveshjet e Stabilizim-Asociimit*), ekonomike (Masa të posaçme për tregtinë *) dhe financiare (CARDS*) mbështesin realizimin duke forcuar procesin e reformave dhe tranzicionit. Bashkëpunimi rajonal* përbën një pjesë themelore të procedurës". Shih *http://ec.europa.eu/enlargement/glossary/terms/sap_en.htm*

E gjithë marrëveshja mbështetet në tre shtyllat e BE-së[7], me fokus kryesor në shtyllën e parë, atë të Komunitetit, veçanërisht në parimet dhe standardet e tregut të brendshëm.

Në lidhje me kuadrin e qeverisjes së korporatave, pjesët kryesore të legjislacionit janë:

- Ligji për shoqëritë tregtare[8];
- Ligji për marrjen në kontroll të shoqërive me ofertë publike[9];
- Ligji për titujt[10];
- Ligji për regjistrimin e bizneseve[11];
- Ligji për bankat[12];
- Ligji për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare[13];
- Ligji për ekspertët kontabël[14].

Sipas nenit 70(3) të MSA-së, këto akte ligjore të hartuara së fundi, ishin pjesë e reformës ligjore në kuadrin e përafrimit të legjislacionit shqiptar me *Acquis Communautaire*, në fazën e

---

[7] Shtyllat e Bashkimit Evropian: Traktati i Maastricht-it (1992) prezantoi një strukturë të re institucionale, e cila mbeti në fuqi deri në Traktatin e Lisbonës. Struktura institucionale përbëhej nga tre "shtylla":

1. shtylla e Komunitetit, e cila përkon me tre Komunitetet: Komuniteti Evropian, Komuniteti Evropian i Energjisë Atomike (Euratom) dhe ish-Komuniteti Evropian për Qymyrin dhe Çelikun (ECSC) (shtylla e parë);
2. shtylla dedikuar politikës së përbashkët për çështje të sigurisë dhe marrëdhëniet me jashtë, e cila ishte në titullin V të Traktatit të Bashkimit Evropian (shtylla e dytë);
3. shtylla dedikuar bashkëpunimit të policisë dhe gjyqësorit për çështje kriminale, e cila ishte në titullin VI të Traktatit të Bashkimit Evropian (shtylla e tretë).

http://europa.eu/legislation_summaries/glossary/eu_pillars_en.htm

[8] Ligji nr. 9901 datë 14.04. 2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar.

[9] Ligji nr. 10236, datë 18.02.2010 "Për marrjen në kontroll të shoqërive me ofertë publike".

[10] Ligji nr. 9879 datë 21.02.2008 "Për titujt".

[11] Ligji nr. 9723 datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit".

[12] Ligji nr. 9662 datë 18.12.2006 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar në dhjetor 2011.

[13] Ligji nr. 9228, datë 29.4.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", i ndryshuar.

[14] Ligji nr. 10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar" i ndryshuar.

parë[15] të zbatimit të MSA-së për fushat e legjislacionit për shoqëritë tregtare dhe shërbimet financiare.

Duke iu referuar Raporteve të Progresit të Komisionit Evropian (EC 2007-2011), reforma e lartpërmendur ligjore duhet ta sjellë Shqipërinë më afër me standardet e BE-së në lidhje me funksionimin e ekonomisë së tregut dhe ato të Tregut të Vetëm Evropian, duke krijuar kështu themele të forta për përmirësim të mëtejshëm.

Në këtë drejtim, ky kuadër i ri ligjor pasqyron zhvillimet e fundit në legjislacionin e BE-së për shoqëritë tregtare. Nga vitet '60 deri në vitet '90, legjislacioni dhe jurisprudenca e BE-së u përqendrua në krijimin e një fushe të përbashkët loje për kompanitë evropiane, duke theksuar rëndësinë e të Drejtës për Vendosje dhe Lëvizjen e Lirë të Kapitalit.[16] Krijimi i shoqërive me fuqi mbikombëtare (*supranational*), kombinuar ndërkohë me tregje financiare të fragmentuara dhe intensifikimi i nevojës për të thithur financim nga investitorë ndërkombëtarë, e shtynë BE-në drejt zhvillimit të tregjeve të kapitalit dhe forcimit të qeverisjes së korporatave.[17] Në teori, kjo do të thoshte kalim nga modeli i "ndikimit të brendshëm" në qeverisje drejt një modeli hibrid; kombinim i modelit të ndikimit të brendshëm me atë të ndikimit të jashtëm, ku ky i fundit mbështetet në tregjet e kapitalit dhe qeverisjen e korporatave.

Si rrjedhojë, edhe kuadri ligjor i qeverisjes së korporatave në

---

[15] Neni 6 parashikon që "Asociimi zbatohet në mënyrë progresive dhe realizohet plotësisht gjatë një periudhe tranzitore deri në dhjetë vjet maksimumi, e ndarë në dy faza të njëpasnjëshme.." ndërsa neni 70(3) parashikon që përafrimi në fazën e parë do të përqendrohet në elementët thelbësorë të Acquis së Tregut të Brendshëm si "konkurrenca, të drejtat mbi pronësinë intelektuale, industriale dhe tregtare, prokurimi publik, standardet dhe certifikimi, shërbimet financiare, transporti detar dhe tokësor – duke i kushtuar rëndësi të veçantë sigurisë dhe standardeve mjedisore si dhe aspekteve sociale – ligji për shoqëritë tregtare, kontabiliteti, mbrojtja e konsumatorit, mbrojtja e të dhënave, shëndeti dhe siguria në punë dhe mundësi të barabarta". Pjesët e mbetura të Acquis do të jenë subjekt i përafrimit gjatë fazës së dytë.

[16] Harmonizimi i ligjeve për shoqëritë tregtare dhe kontabilitetin nëpërmjet shteteve anëtare: Direktiva e parë e Këshillit 68/151/EEC; Direktiva e dytë e Këshillit 77/91/EEC; Direktiva e katërt e Këshillit 78/660/EEC; Direktiva e shtatë e Këshillit 83/349/EEC; Lëvizja e lirë e kapitalit Direktiva 88/361/EEC.

[17] Një moment i rëndësishëm për këto reforma ishte Plani i Veprimit për Modernizimin e Ligjit për shoqëritë tregtare dhe Përmirësimi i Qeverisjes së Korporatave në BE", 21 maj 2003 {COM(2003) 284}.

Shqipëri është një ndërthurje e dy modeleve të ndikimit, duke siguruar infrastrukturën ligjore për një treg kapitali funksional.

Në nenin 1 të Ligjit për Titujt parashikohet si më poshtë: "... rregullon mënyrën dhe kushtet për emetimin e titujve, tregtimin dhe regjistrimin, identifikimin dhe kryerjen e transaksioneve me to, përcakton personat dhe individët e autorizuar për kryerjen e transaksioneve me titujt, kushtet për organizimin e tregtimit publik të titujve, mbrojtjen e investitorëve dhe të mbajtësve të të drejtave mbi titujt, kushtet për dematerializimin e titujve, organizimin e funksionimin e regjistrave të titujve, shkëmbimin dhe rregullimin e tregut të titujve".

Në vitin 1996 u themelua Bursa e Tiranës, e licencuar së fundi edhe nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, sipas kërkesave të reja të Ligjit për titujt.

Më tej, kërkesat ligjore për publikimin dhe transparencën e informacionit financiar janë përmirësuar në masë të konsiderueshme. Nenet 28 dhe 29 të Ligjit për titujt parashikojnë detyrimin e kompanive për përgatitjen dhe publikimin e prospektit sipas parimeve, procedurave dhe kërkesave ligjore si për objektin edhe për përmbajtjen e prospektit. Ligji për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare i detyron bankat dhe kompanitë e tjera relativisht të mëdha (me të ardhura mbi 1.250.000.000 lekë gjatë dy viteve të fundit dhe me 100 ose më shumë punonjës) të adoptojnë Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për pasqyrat e tyre financiare (Neni 4 i Ligjit dhe pika 2 e VKM nr. 742, datë 07.11.2007). Ligji për regjistrimin (QKR), përveç lehtësive për regjistrimin online të bizneseve, sanksionon publikimin e detyrueshëm të dokumenteve vjetore të kontabilitetit dhe të dhëna të tjera në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, të cilat bëhen të disponueshme elektronikisht për publikun. Gjithashtu, Ligji për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar, i miratuar kohët e fundit parashikon kërkesa shtesë për cilësinë e raportimit. Ai "...synon përmirësimin dhe forcimin e mbikëqyrjes publike të profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe kontabilistit të miratuar" (neni1/1). Ky ligj rregullon edhe pasqyrat financiare vjetore individuale dhe të konsoliduara, si dhe

organizimin dhe funksionimin e kompanive të auditimit dhe të organizatave profesionale të kontabilistëve të miratuar.

Një prej zhvillimeve më të rëndësishme në fushën ligjore ishte miratimi i Ligjit të ri për shoqëritë tregtare, i cili synon të krijojë një sistem të thjeshtë, të qartë dhe të përditësuar. Ai ka adoptuar standardet të BE-së për legjislacionin për shoqëritë tregtare, qeverisjen e korporatave dhe përgjegjësinë shoqërore. Sipas ligjit të ri, për sa i përket kuadrit organizativ, shoqëritë aksionere janë të lira të zgjedhin midis modelit të qeverisjes me një apo atij me dy nivele, në ngjasim me ligjin italian për shoqëritë tregtare. Në sistemin me dy nivele, kompania qeveriset nga Këshilli Mbikëqyrës, i zgjedhur nga Asambleja e Përgjithshme e Aksionerëve, dhe Këshilli i Administrimit, i zgjedhur ose nga Asambleja ose nga Këshilli Mbikëqyrës. Dizenjimi opsional i organeve drejtuese të shoqërisë është parashikuar me synim lehtësimin e operacioneve të biznesit. Ky opsion, ofron një ndërthurje të dy sistemeve të ndryshme të qeverisjes së korporatave. Sistemi me një nivel, i përmendur në Kapitullin 2 gjendet në vendet e *Common Law* (modeli i ndikimit të jashtëm), ndërsa sistemi me dy nivele është tipar dallues i legjislacionit gjerman për shoqëritë tregtare. Në mendimin tonë, zbatimi i këtij opsioni kërkon kujdes të veçantë në të ardhmen, pasi mund të sjellë më shumë paqartësi sesa të rezultojë lehtësues dhe mbështetës për tërheqjen e investitorëve të kapitalit, e për rrjedhojë për zhvillimin e tregut të kapitalit. Më konkretisht, asimetritë e informacionit, integriteti i pasqyrave financiare dhe praktika të ndryshme të qeverisjes së korporatave që rrjedhin nga këto opsione, të ndërthurura me mungesën e njohurisë dhe përvojës në qeverisjen e korporatave, mund të kenë efekt të kundërt mbi zhvillimin e këtij tregu.

Një risi tjetër e sjellë nga ky ligj është shfuqizimi i dispozitave për përfaqësimin e detyrueshëm të punonjësve në Këshillin Mbikëqyrës. Sipas ligjit të shfuqizuar, një e treta e këshillit duhej të caktohej nga punonjësit. Megjithatë, nuk ka patur prova për zbatimin e kësaj dispozite në të shkuarën. Ligji i ri për shoqëritë tregtare parashikon anëtarësinë opsionale të përfaqësisë së punonjësve me marrëveshje ndërmjet drejtimit të kompanisë dhe punëmarrësve (neni 21). Megjithatë, në linjë me standardet evropiane, drejtimi

i shoqërisë tregtare ka detyrimin ligjor të informojë këshillin e punëmarrësve, dhe ky i fundit gëzon të drejtën për t'u informuar drejtpërdrejt në lidhje me veprimtari, vendime, politika dhe strategji që prekin interesat e punëmarrësve. Sërish sipas këtij ligji, ky Këshill gëzon të drejtën për të dhënë mendime dhe rekomandime dhe për të marrë informacion në lidhje me trajtimin e punonjësve (neni 20).

Një tjetër zhvillim i rëndësishëm është nisma nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për nxitjen e Përgjegjësisë Sociale të Korporatave (PSK) të aktorëve ekonomikë, rregullatorët dhe organet vendimmarrëse. Projekti është duke u zhvilluar nga një grup pune ndërinstitucional, përfaqësues të biznesit dhe aktorë të tjerë. Ai synon nxjerrjen e një dokumenti politikash për reforma të mëtejshme në këtë fushë me qëllim përafrimin me standardet e BE-së. Në draftin e parë të këtij dokumenti, Qeveria Shqiptare thekson angazhimin e saj për nxitjen e PSK-së si element kyç për konkurrencën e qëndrueshme në ekonominë shqiptare. Drafti përmban edhe një plan paraprak veprimi i hartuar duke u bazuar në rezultatet e analizës SWOT të situatës aktuale të PSK-së në Shqipëri.

Një aspekt tjetër i rëndësishëm në analizën tonë është pozicioni ligjor dhe strukturor që zënë bankat në modelin shqiptar të qeverisjes së korporatave. Sipas Claessens (2004), bankat dhe tregjet e kapitalit kanë funksione plotësuese të njëri- tjetrit si dy burime financimi. Sipas vëzhgimeve të tij, në vendet ku ka një sektor bankar të mirëzhvilluar, rritja ekonomike për frymë është më e lartë, pavarësisht nga niveli i likuiditetit dhe i sofistikimit të tregut të kapitaleve.

Megjithatë, siç u përmend në kapitullin 2, bankat kanë një rol vendimtar në rastin e modelit të "ndikimit të brendshëm", ku financimi nga tregu i kapitalit nuk është i mirëzhvilluar. Bankat që veprojnë në Shqipëri, në ndryshim nga ato në Gjermani dhe Japoni, hasin kufizime ligjore për investime në kapital në shoqëri të tjera tregtare jofinanciare. Sipas nenit 70 të kapitullit V - "Administrimi i rrezikut" - i Ligjit për bankat, mund të supozohet se këto kufizime janë për qëllime prudenciale. Në të vërtetë, bankat që veprojnë në Shqipëri mund të blejnë deri në 10% të kapitalit të një shoqërie

tregtare. Megjithatë, ky investim nuk duhet të kalojë në asnjë rast 15% të kapitalit rregullator të bankës sipas kërkesave rregullative. Në shoqëritë tregtare me pronësi të decentralizuar (*dispersed ownership*), kufizimi prej 10% mund t'u japë bankave, në mos shumicën e aksioneve dhe të drejtat e votës, të paktën një pozicion kontrollues, të ngjashëm me atë të "bankës kryesore" në Gjermani dhe "*keiretsu*" në Japoni. Megjithatë, pika 5 e nenit 70 parashikon disa përjashtime. Konkretisht, këto kufizime nuk zbatohen për:

"a) përfitimin e aksioneve ose të të drejtave të tjera të pronësisë kundrejt shlyerjes së kredive të dhëna. Në këtë rast, banka përfituese i disponon të gjitha aksionet ose të drejtat e pronësisë të fituara për një vit, me përjashtim të rastit kur Banka e Shqipërisë e ka zgjatur këtë afat;

b) përfitimin e aksioneve ose të drejtave të tjera të pronësisë nga banka ose dega e një banke të huaj si agjent ;

c) blerjen e aksioneve ose të të drejtave të pronësisë, me qëllim rishitjen e tyre tek të tretët."

Nga përmbajtja e dispozitave të nenit 70, rezulton se investimet e bankave mbi kufijtë prej 10% dhe 15%, janë të kushtëzuara. Nga interpretimi gjuhësor dhe logjik i këtyre dispozitave, mund të identifikohen dy lloje kushtesh shtesë: (i) mbajtja afatshkurtër e aksioneve nga një bankë, dhe (ii) qëllimi dhe arsyeja e caktuar për marrjen e këtij numri aksionesh të një shoqërie tregtare.

(i) Ndërsa në rastin "a" më lart, kufizimi kohor është i përkufizuar qartë, në rastin "b", koha presupozohet të rrjedhë nga kushtet e kontratës së agjencisë. Në rastin "c" situata duket disi e paqartë. Ne nuk identifikuam ndonjë rast konkret në praktikën bankare deri më sot për materializimin e kësaj dispozite. Megjithatë, në frymën dhe formulimin strikt gjuhësor të të gjithë nenit 70, mbajtja e aksioneve të blera duhet të jetë e përkohshme dhe banka duhet të informojë autoritetin mbikëqyrës mbi kohën kur parashikon t'i shesë.

(ii) Në të tria rastet, tejkalimi i kufijve lejohet për arsye të lidhura ngushtë me veprimtarinë bankare. Në rastin "a", përjashtimi parashikon mundësinë e rikthimit të fondeve të dhëna hua nga

banka në rastin e mosshlyerjes nga ana e klientit. Rastet "b" dhe "c" mund të konsiderohen si transaksione në kuadrin e shërbimeve konvencionale të ndërmjetësimit dhe të konsulencës që bankat u ofrojnë klientëve.

Nga analiza e mësipërme, bankat mund të ndikojnë qeverisjen e korporatave në shoqëritë tregtare nëse shuma 10% e aksioneve u lejon pozicion kontrollues mbi drejtimin e kompanisë. Nga ana tjetër, siç u përshkrua më lart bankat shqiptare mund të luajnë rolin e një "banke kryesore" sipas modelit "të ndikuesve të brendshëm" në raste përjashtimore, sidomos në rastin "a". Megjithatë, natyra "e përkohshme" e veprimit të këtyre përjashtimeve, nuk eliminon mundësinë e pasojave negative me efekt të kundërt në kompanitë aksionet e të cilave banka do të mbajë për një vit.

Për rrjedhojë, mund të arrijmë në përfundimin se ligji në përmbajtjen e tij sipas formulimit strikt gjuhësor parashikon një model të kombinuar/hibrid për qeverisjen e korporatave në Shqipëri, duke u fokusuar në vendosjen e një infrastrukture të duhur ligjore për një treg financiar të jashtëm funksional (tregu i kapitalit). Gjithsesi, për të përcaktuar plotësisht një model për Shqipërinë, do të na duhet të shohim faktorë përtej përmbajtjes së ligjit, duke nxjerrë përfundime nga analizimi i zbatimit dhe implementimit të ligjit në praktikë.

3.2 SITUATA AKTUALE

Siç u shpreh në pjesët e mëparshme të punimit, që një treg financiar të mirëfunksionojë dhe të kontribuojë në rritjen ekonomike të vendit, duhet të ketë themele të forta ligjore dhe një sundim të efektshëm të së drejtës (Claessens 2003, Shleifler dhe Vishny 1997). Kështu, ndërtimi i një infrastrukture moderne ligjore duhet të ecë paralelisht me ndërtimin e kapaciteteve institucionale për zbatimin e ligjit e një sistem gjyqësor efektiv. Neni 70 i MSA-së parashikon se përafrimi i efektshëm i legjislacionit nuk do të thotë vetëm inkorporim të *Acquis* në legjislacionin vendas, por edhe sigurimin për zbatimin dhe forcimin e tij me efektshmëri. Ky detyrim përforcohet në nenin 78, i cili përqendrohet te rëndësia

e konsolidimit të sundimit të së drejtës, sistemit gjyqësor dhe institucioneve të tjera administrative të zbatimit të ligjit.

Duke pasur parasysh praktikat e zbatimit të ligjit, analiza jonë mbi modelin e qeverisjes së korporatave në Shqipëri përqendrohet në tri përcaktues me rëndësi të njëtrajtshme: cilësia e legjislacionit nga pikëpamja e efektshmërisë, cilësia e organeve zbatuese dhe struktura e pronësisë të kompanive shqiptare.

Pas hyrjes në fuqi të Ligjit për shoqëritë tregtare, Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) vlerësoi qeverisjen e korporatave në Shqipëri. Vlerësimi vë në dukje se me ligjin e ri janë bërë përmirësime; megjithatë, ai ka ende nevojë për harmonizim me legjislacionin e BE-së në këtë fushë dhe kapacitetet e institucioneve për zbatimin e tij duhen forcuar më tej. Grafiku 3.1 tregon se pavarësisht nga reformat ligjore, publikimi i informacionit financiar dhe transparenca mbeten në nivele të dobëta, ashtu si edhe e drejta e aksionerëve dhe trajtimi i aksionerëve të pakicës. Në të vërtetë, këto gjetje janë konfirmuar nga procesi i vlerësimit të progresit të Shqipërisë nga Komisioni Evropian (EC, 2010 dhe 2011).

Grafik 3.1 Cilësia e qeverisjes së korporatave dhe legjislacionit në Shqipëri



Burimi: BERZH, 2010.

Cilësia e publikimit të informacionit financiar, struktura e pronësisë, si dhe një mjedis i shëndetshëm ligjor kanë ndikim kumulativ mbi funksionimin e tregut të kapitaleve. Ndonëse Bursa e

Tiranës është krijuar që në vitin 1996, ende nuk ka asnjë kompani aksionere të listuar nga 725 të tilla të regjistruara në QKR (EC, 2011, BT 2002-2010).

3.2.1 PUBLIKIMI I INFORMACIONIT FINANCIAR

Pavarësisht reformave ligjore për raportimin financiar dhe kontabilitetin, perceptimi në Shqipëri mbi besueshmërinë e informacionit financiar të shoqërive tregtare, veçanërisht të SME-ve, mbetet i ulët. Gjithashtu, megjithëse raportimi vjetor i informacionit kontabël në regjistrin elektronik në QKR është i detyrueshëm, zbatimi i dobët i kësaj kërkese ligjore nxjerr në pah paaftësinë zbatuese dhe shtrënguese të ligjit nga QKR (EC, 2010 dhe 2011).

Ligji për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare përcakton se përfaqësuesit ligjorë të shoqërive tregtare janë të ngarkuar me përgjegjësi ligjore për besueshmërinë e pasqyrave financiare por nuk parashikon asnjë sanksion për Këshillin Mbikëqyrës. Nga ana tjetër, Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit (KKK) - autoriteti mbikëqyrës, përgjegjës për zbatimin e standardeve të kontabilitetit - nuk ka kapacitete të mjaftueshme mbikëqyrëse për zbatimin e tyre (EC, 2011, f. 33).

Më tej, përpilimi dhe përmbajtja e pasqyrave financiare janë të orientuara më shumë drejt përmbushjes së detyrimeve tatimore se sa drejt tërheqjes së investitorëve. Mosfunksionimi i Bursës së Tiranës ul ndjeshëm kërkesën për raporte financiare cilësore, të cilat janë një mjet i rëndësishëm për tërheqjen e financimit të jashtëm.

3.2.2 STRUKTURA E PRONËSISË

Sipas përkufizimit të BE-së për Sipërmarrjet e Vogla dhe të Mesme (SME-të)[18], ato përfaqësojnë pothuaj 100% të sipërmarrjeve në ekonominë shqiptare (Grafiku 3.2). Megjithëse SME-të

[18] Rekomandimi i Komisionit (2003/361/EC) në lidhje me përkufizimin e sipërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme, 6 maj 2003. Sipas përkufizimit, sipërmarrjet e mesme punësojnë më pak se 250 persona.

konsiderohen si motori i nxitjes së rritjes ekonomike, siç paraqitet në Grafikët 3.3 dhe 3.4, rreth 78.5% e SME-ve janë sipërmarrje mikro me një person të vetëm (person fizik), 17.1% janë kompani me përgjegjësi të kufizuar dhe 0.7% janë kompani aksionere. Sipërmarrjet shqiptare janë kryesisht sipërmarrje familjare me strukturë tejet të përqendruar të pronësisë, numër shumë të vogël punonjësish dhe normë të ulët të zgjerimit të aktivitetit. Në mungesë të një tregu funksional të kapitalit, SME-të e financojnë veprimtarinë kryesisht nëpërmjet burimeve të brendshme (informale) dhe kredive bankare. Këta faktorë, nuk krijojnë nxitje të mjaftueshme për prodhimin e raporteve financiare cilësore nga pronarët, duke mbajtur larg ndërkohë investitorët për shkak të kostove të larta të investimit. Në pjesën më të madhe të rasteve, vendimmarrja e bankave për akordiminin e kredisë nuk mbështetet në pasqyra financiare zyrtare, por në vlerësimin e kolateralit, planet e biznesit dhe informacionin e marrë nga inspektimet në terren.

Nisur nga kjo strukturë, Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, në dhjetor 2011, prezantoi kodin e brendshëm për qeverisjen e korporatave për shoqëritë tregtare të palistuara. Kodi përfshin praktikat më të mira ndërkombëtare dhe konsiderohet si udhërrëfyes për qeverisjen e efektshme të shoqërive tregtare të palistuara, nëpërmjet përcaktimit të roleve, përgjegjësive si dhe dallimin e qartë të kompetencave të aksionerëve, të Këshillit Mbikëqyrës, të drejtuesve ekzekutivë dhe të aktorëve të tjerë. Kodi

Grafik 3.2 Sipërmarrjet aktive sipas numrit të punonjësve.
(Përqindja e SME-ve)



Burimi: INSTAT 2010.

konsiderohet një domosdoshmëri për arritjen e standardeve të BE-së dhe reformimin e qeverisjes së korporatave, ndërkohë që ndërton besimin e investitorëve të huaj në shoqëritë shqiptare (Bozdo 2011).

Grafik 3.3 Përqindja e sipërmarrjeve aktive sipas formës ligjore.



Burimi: INSTAT 2010.

Grafik 3.4 Numri i sipërmarrjeve aktive sipas formës ligjore.



Burimi: INSTAT 2010.

3.2.3 MJEDISI LIGJOR - SUNDIMI I SË DREJTËS

Pengesa për zhvillimin e tregut financiar dhe përmirësimin e cilësisë së investimit mbeten mungesa e zbatimit efektiv të ligjit dhe e një sistemi gjyqësor eficient. Më në përgjithësi, performanca

e sistemit gjyqësor vijon të pengojë progresin e Shqipërisë në të gjitha fushat. Mangësitë lidhen me pavarësinë, transparencën dhe eficiencën e këtij sistemi. Në shumë raste, vendimet e gjykatave nuk janë plotësisht transparente, zbatimi i tyre zvarritet dhe nuk është i plotë. Komisioni Evropian e përcakton sistemin gjyqësor si një prej fushave ku korrupsioni është mbizotërues në Shqipëri dhe besimi i publikut në të është shumë i ulët (EC, 2007-2011). Ndër shkaqet e këtyre problemeve janë trajnimi i pamjaftueshëm, kapacitete profesionale nën nivelin e kërkuar dhe sistem joeficient i vlerësimit të performancës. Shpesh, emërimi i gjyqtarëve është subjekt i polemikave politike, duke kufizuar kështu pavarësinë e sistemit. Zbatimi i kontratave dhe siguria ligjore mbeten probleme që shpesh çojnë në metoda informale të zbatimit të tyre.

QKR-ja nuk ka kompetenca të mjaftueshme shtrënguese për respektimin e dispozitave të Ligjit të ri për shoqëritë tregtare. Shumë prej shoqërive nuk i kanë përditësuar aktet statutore të tyre sipas kërkesave të ligjit të ri, duke e detyruar QKR-në të shtyjë afatin. Kjo vonesë ka bërë që komisioni parlamentar të refuzojë propozimet për ndryshimin e Ligjit për shoqëritë tregtare, si për shembull, në lidhje me rritjen e kapitalit fillestar të paguar për shoqëritë aksionere (Shekulli, 2011).

Në përfundim, rezulton se problemet me të cilat përballet Shqipëria, të përmbledhura në seksionin 3.1 të këtij kapitulli, janë të njëjta me ato që përballen të gjitha vendet në tranzicion. Pavarësisht nga modeli i qeverisjes së korporatave, i dizenjuar në përmbajtjen e legjislacionit, në Shqipëri mungojnë tregjet e kapitalit. Kjo mungesë sjell si pasojë burime të kufizuara financiare për zgjerim të biznesit si dhe mungesë të monitorimit të drejtimit të kompanive nga forcat e tregut. Kredia bankare mbetet burimi më i rëndësishëm formal i financimit, duke përfaqësuar 95% të aktiveve të sektorit financiar. Rrjedhimisht, në kushtet e mungesës së sundimit të së drejtës dhe të informacionit të besueshëm financiar, roli thelbësor i bankave në ekonominë shqiptare dhe pronësia tejet e përqendruar indikojnë për një model të "ndikimit të brendshëm" të qeverisjes së korporatave në Shqipëri. Si rezultat, mendojmë se më shumë vëmendje duhet t'u kushtohet qeverisjes së shëndetshme të bankave dhe rolit të autoritetit mbikëqyrës si agjent të interesit të depozituesve dhe kreditorëve.

4. QEVERISJA NË BANKAT SHQIPTARE

4.1 VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM

4.1.1 KRIZA FINANCIARE NË SEKTORIN BANKAR SHQIPTAR

Kriza financiare globale e kohëve të fundit nuk preku shumë bankat shqiptare për shkak kryesisht të fazës së zhvillimit, integrimit të ulët me tregjet financiare globale dhe rregullimit dhe mbikëqyrjes prudenciale nga Banka e Shqipërisë (FMN, 2011). Megjithatë, sistemi bankar u përball me një rënie të theksuar të depozitave, e cila mund t'i adresohet perceptimit dhe kujtesës së hidhur të publikut mbi rënien e skemave piramidale në vitin 1997. Portofoli i depozitave u rimëkëmb shpejt si pasojë e masave prudenciale të ndërmarra nga autoriteti mbikëqyrës. Pas krizës, një shqetësim tjetër u shfaq në lidhje me rritjen e kredive me probleme, të cilat shënuan rritje nga niveli 3% para krizës, në 16.6% në tremujorin e dytë të vitit 2011 (EC 2011, FMN 2011). Sipas FMN-së (2011), rritja e nivelit të kredive me probleme ka ardhur pjesërisht si pasojë e kapaciteteve të dobëta institucionale dhe gjyqësore, të cilat kanë penguar ekzekutimin e kolateralit, dhe pjesërisht si pasojë e ngadalësimit të aktivitetit ekonomik. Megjithatë, ne besojmë se niveli i lartë i kredive me probleme mund të mbështetet edhe në faktorë të tjerë, përfshirë këtu edhe elementë të qeverisjes së bankave.

Gjatë viteve 2008-2010, në përgjigje të efekteve potenciale të tërthorta të krizës financiare globale mbi sektorin bankar shqiptar, autoriteti mbikëqyrës ndërmori në bashkëpunim me bankat masa më strikte ligjore e rregullatore. Pjesë e masave të reja ligjore ishin gjithashtu edhe çështje të qeverisjes së korporatave. Në fillim të vitin 2009, u ndryshua Ligji për sigurimin e depozitave[19] duke rritur nivelin e depozitave të siguruara, nismë e cila rezultoi me efekte pozitive për rivendosjen e besimit të publikut në sistemin bankar. Megjithatë, efektet e kundërta të mundshme të kësaj nisme mbi sjelljen e bankave për të marrë përsipër rrezik, nuk janë vlerësuar ende. Masa të tjera ligjore përfshijnë: politika dhe procedura për administrimin e rrezikut që përcaktojnë përgjegjësitë e këshillit

[19] Ligj Nr. 10 106, datë 30.3.2009 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 8873, datë 29.3.2002 "Për sigurimin e depozitave".

drejtues dhe të drejtuesve ekzekutivë; publikimin e informacionit financiar dhe transparencën mbi produktet dhe shërbimet e ofruara; dhe sistemin e auditit të brendshëm dhe auditit të jashtëm.[20]

Ndryshimet ligjore më inovatore në lidhje me qeverisjen e korporatave ishin miratimi i një rregulloreje të re në vitin 2009, e cila përcakton parimet dhe rregullat bazë për menaxhimin e përgjegjshëm dhe eficient të bankave dhe degëve të bankave të huaja si dhe kriteret për miratimin e administratorëve të bankave (parimi i ashtuquajtur *fit-and-proper*).[21] Këto masa rregullative u pasuan në nëntor të vitit 2011 nga ndryshimi i numrit minimal të anëtarëve të pavarur të Këshillit Mbikëqyrës nga një e treta në shumicën e këshillit, i përcaktuar në Ligjin për bankat.

Vëmendja gjithmonë e më e madhe e Bankës së Shqipërisë mbi qeverisjen e korporatave në banka u pasqyrua edhe në Strategjinë afatmesme të zhvillimit për mbikëqyrjen bankare 2009-2014 (Banka e Shqipërisë, 2009). Një prej sfidave të mbikëqyrjes bankare e shprehur në këtë Strategji është "Rritja e kapaciteteve të bankave vendase për të administruar në mënyrë të pavarur të gjitha rreziqet që ato hasin në veprimtarinë e tyre dhe zbatimi i standardeve të larta për një kulturë drejtimi" (Banka e Shqipërisë, 2009, f. 9). Në të njëjtin dokument, Banka e Shqipërisë angazhohet të përmirësojë proceset e mbikëqyrjes duke u përqendruar në inspektimin dhe vlerësimin e drejtpërdrejtë të qeverisjes së korporatave në banka, përgjegjësitë e këshillit drejtues dhe organeve të tjera drejtuese për administrimin e rrezikut dhe procese të shëndetshme biznesi.

---

[20] Administrim i rrezikut: Rregullore Nr. 31 "Për administrimin e rrezikut nga ekspozimet e mëdha të bankave" (2009); Rregullore Nr. 71 "Mbi administrimin e rrezikut të likuiditetit" (2009); Rregullore Nr. 48 "Për administrimin e rrezikut nga pozicionet e hapura valutore" (2010); Rregullore Nr. 62 "Për administrimin e rrezikut të kredisë" (2011); Rregullore Nr. 03 "Mbi administrimin e rrezik operacional" (2011). Publikimi i informacionit financiar dhe transparenca: Rregullore Nr. 59 "Mbi transparencën për produktet dhe shërbimet bankare e financiare" (2008); Rregullore Nr. 60 "Për kërkesat minimale të publikimit të informacionit nga bankat dhe degët e bankave të huaja"(2008); Rregullore Nr. 45, "Mbi raportimet në Bankën e Shqipërisë sipas sistemit Raportues të Unifikuar" (2009). Sistemet e auditimit të brendshëm dhe të jashtëm: Rregullore Nr. 24 "Për sistemin e kontrollit të brendshëm në bankat dhe degët e bankave të huaja" (2008); Rregullore Nr. 06 "Për ekspertin kontabël të autorizuar të bankave dhe degëve të bankave të huaja" (2011), e ndryshuar.

[21] Ibid, supra et 23

Dokumenti mbi Misionin e Mbikëqyrjes Bankare në vitin 2010 e përforcoi më tej këtë qasje, në përputhje me atë të Bazelit dhe BE-së, duke shprehur se Banka e Shqipërisë, në zbatim të përgjegjësive ligjore, synon të siguroje stabilitetin e sistemit bankar duke [...] rekomanduar masat e nevojshme, në mënyrë që subjektet e mbikëqyrura t'iu përshtaten këtyre zhvillimeve dhe të administrohen në vazhdimësi sipas praktikave më të mira" (Banka e Shqipërisë, 2010 f. 1).

Këto reforma ligjore dhe rregullative ngrejnë një bazë të shëndoshë për qeverisjen e bankave, çfarë nënkupton se Banka e Shqipërisë e percepton qeverisjen e shëndoshë si një burim endogjen për stabilitetin financiar. Në përforcim të kësaj qasjeje, në fillim të vitit 2010, brenda institucionit u krijua një grup pune[22] për të vlerësuar zbatimin e kuadrit ligjor dhe ndërtimin e një indeksi për vlerësimin e qeverisjes së korporatave në banka.

4.1.2 KONKURRENCA DHE STRUKTURA E PRONËSISË E BANKAVE QË VEPROJNË NË SHQIPËRI

Në Shqipëri ushtrojnë veprimtari bankare dhe financiare 16 banka private, me aksionerë individualë dhe grupe të mëdha bankare evropiane (shih Kapitullin 2). Struktura e pronësisë së kapitalit është tejet e përqendruar, me përjashtim të një banke që përfaqëson numrin më të lartë të aksionerëve dhe strukturën më të shpërndarë (Tabelë 4.1). Tetë banka janë në pronësi të një aksioneri të vetëm, kryesisht banka mëmë evropiane, ndërsa katër banka kontrollohen nga një aksioner i vetëm me më shumë se 50% të aksioneve.

[22] Grupi i punës përbëhej nga përfaqësues të departamenteve të Mbikëqyrjes, Kërkimeve dhe Burimeve Njerëzore të Bankës së Shqipërisë.

Tabelë 4.1 Struktura e pronësisë dhe numri mesatar i aksionerëve në bankat që veprojnë në Shqipëri.

Pjesëmarrja në pronësi (%) Pjesëmarrja më e lartë nga një aksioner i vetëm	Numri i bankave (nga 16)	Përqindja më e lartë e aksioneve e mbajtur në këtë grup bankash	Përqindja më e ulët e aksioneve e mbajtur në këtë grup bankash	Numri mesatar i aksionerëve në këtë grup bankash	Komente
Pronësi e plotë 100%	10	100%	96.70%	1.3	Këtu përfshihen dy banka, ku përqindja më e lartë e aksioneve e mbajtur nga një aksioner i vetëm është përkatësisht 96.70% dhe 99.61%, pra 8 banka janë në pronësi të plotë nga një aksioner i vetëm, kryesisht institucione financiare.
80% - 90%	3	87.47%	83.13%	5	Numri më i vogël i aksionerëve 2, numri më i lartë i aksionerëve 9
50% - 80%	1	55%	0.5%	12	Vetëm një bankë ka shënuar përqindjen më të lartë të aksioneve nga një aksioner i vetëm 55%
30% - 50%	1	33.35%	33.30%	3	Pothuajse blloqe të barabarta aksionesh
≤30%	1	24.89%	0.29%	15	E vetmja bankë me strukturë pronësie të shpërndarë

Burimi: Banka e Shqipërisë, nëntor 2011, llogaritje të autorëve.

Sikurse mund të vërehet, struktura e pronësisë së bankave është e ngjashme me atë të kompanive të tjera në Shqipëri. Kjo tregon për një model "të ndikuesve të brendshëm" të qeverisjes së korporatave në sektorin bankar me një forcë të brendshme të fortë monitoruese dhe kontrolluese të aksionerëve mbi drejtimin e bankave.

Në Kapitullin 2, ne arritëm në përfundimin se konkurrenca në sektorin bankar mund të ishte një forcë e jashtme nxitëse për një qeverisje të mirë të korporatave. Ndryshe nga kompanitë e zakonshme, konkurrenca e pakufizuar në rastin e bankave mund të ketë efekte të kundërta mbi ecurinë financiare të një banke të vetme dhe/ose stabilitetin financiar të të gjithë sistemit (Note, 2006, f. 6). Rrjedhimisht, rregullimi bankar i cili përcakton kërkesa për kapital fillestar, kapital rregullator, mjaftueshmëri të kapitalit, dhe ato për kriteret e duhura dhe të përshtatshme që duhet të kenë administratorët e bankave, kufizojnë konkurrencën në përputhje me pritshmëritë e autoritetit rregullator mbi stabilitetin financiar.

Note (2006) ka matur nivelin e konkurrencës në sektorin bankar shqiptar me metodologjinë Panzar-Rosse (PR).[23] Ajo gjen se konkurrenca e bankave është e moderuar, çfarë është nivel i kënaqshëm duke patur parasysh fazën e zhvillimit të Shqipërisë. Llogaritjet e Indeksit Herfindahl Hirschman (HHI) gjatë gjashtëmujorit të parë 2011 (RSF, Banka e Shqipërisë, 2011, f. 63)[24] tregojnë se niveli i konkurrencës mbetet i moderuar që prej vitit 2007, përfshirë këtu asetet, huatë dhe depozitat (Tabela 4.2).

Në bazë të këtyre rezultateve, ne besojmë se konkurrenca e moderuar[25], së bashku me rregullimin bankar prudencial shërbejnë si një forcë e jashtme nxitëse e përmirësimit të qeverisjes së bankave.

Tabelë 4.2 Indeksi Herfindahl Hirschman (HHI).

HHI	Mjete	Hua	Depozita
1999	4,795	3,316	5,719
2000	4,382	2,727	4,966
2001	3,757	2,011	4,282
2002	3,226	1,729	3,676
2003	3,016	1,459	3,487
2004	2,736	1,150	3,107
2005	2,110	1,035	2,391
2006	1,775	1,095	2,003
2007	1,550	1,121	1,743
2008	1,506	1,188	1,732
2009	1,433	1,115	1,555
2010	1,421	1,126	1,503
2011 (Qershor)	1,449	1,119	1,525

Burimi: Banka e Shqipërisë, 2011.

[23] Note (2006, f. 10) shpjegon se sipas metodologjisë PR "në varësi të nivelit të konkurrencës në treg, bankat shfaqin sjellje të ndryshme në vendosjen e çmimeve ndaj ndryshimeve në kostot e tyre. Për të matur nivelin e konkurrencës me të cilin bankat ballafaqohen në treg, metodologjia studion marrëdhënien mes të ardhurave të fituara nga bankat dhe kostove që janë krijuar për të gjeneruar këto të ardhura.".

[24] Banka e Shqipërisë, "Raporti i Stabilitetit Financiar 2011 6M1" (2011) gjendet online edhe në http://ww.bankofalbania.org/web/Financial_Stability_Report_2011_H1_6305_2.php.
Indeksi HHI interpretohet si më poshtë: 0.01 (ose 100) tregon konkurrencë të lartë; 0.1 – 0.18 (ose 1,000 deri në 1,800) = përqendrim të moderuar; mbi 0.18 (ose 1,800) = përqendrim i lartë.

[25] Konkurrenca monopol ndodh kur ka shumë kompani në treg, por secila prej tyre përqendrohet në segmente gjeografike specifike apo ofrojnë shërbime me veçori të ndryshme. Prandaj, është e mundur që kompanitë të ushtrojnë pushtet të tregut deri në një masë të caktuar dhe të kenë fitime më të larta se normalja.

E thënë shkurt, pronësia tejet e përqendruar mund të ndikojë disi mbi rolin e aksionerëve, këshillin drejtues si dhe marrëdhëniet specifike mes aktorëve të interesuar (*stakeholders*) (aksionerët-drejtuesit-depozituesit/kreditorët-agjencia rregullatore). Nga ana tjetër, konkurrenca e moderuar mund të konsiderohet si forcë e jashtme tregu në sektorin bankar.

Në seksionin në vijim, paraqitet një analizë e hollësishme e kuadrit ligjor të qeverisjes së korporatave dhe efektshmërinë e tij, me fokus në këshillin drejtues, mbështetur në ndikimin e Parimeve të Bazelit për qeverisjen e korporatave të institucioneve financiare, të trajtuara në Kapitullin 2.

4.2 KUADRI LIGJOR PËR QEVERISJEN E BANKAVE NË SHQIPËRI

Kuadri ligjor për qeverisjen e bankave në Shqipëri përbëhet nga Ligji për bankat, Ligji për shoqëritë tregtare, rregullorja për parimet e administrimit bazë të bankave dhe degëve të bankave të huaja[26] dhe një sërë rregulloresh të tjera bankare të nxjerra nga Banka e Shqipërisë në zbatim të Ligjit për bankat. Bankat krijohen si shoqëri aksionere.[27] Ndaj, ato janë subjekt i pjesës më të madhe të dispozitave të Ligjit për shoqëritë tregtare mbi qeverisjen e korporatave, ndonëse organizimi dhe qeverisja e tyre rregullohen në mënyrë specifike në Kapitullin III të Ligjit për bankat.

Këto dy akte ligjore zakonisht plotësojnë njëra-tjetrën, ndonëse në disa raste ato mbivendosen. Ndërkohë që dispozitat e qeverisjes së korporatave në Ligjin për bankat marrin shkas nga interesi për stabilitetin financiar dhe rëndësinë sistemike të bankave, dispozitat

[26] Rregullorja e miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë Nr. 40, datë 27.05.2009, "Mbi parimet bazë të drejtimit të bankave dhe degëve të bankave të huaja dhe kriteret për miratimin e administratorëve të tyre". Kjo rregullore shfuqizon Rregulloren "Për administratorët e bankave dhe degëve të bankave të huaja" të miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës Nr. 120, datë 30.12.2003, e ndryshuar. Rregullorja e re e zgjeron objektin e saj duke përkufizuar parimet e drejtimit të bankave dhe përgjegjësinë e organeve drejtuese për zbatimin e këtyre parimeve sipas Parimeve të Bazelit për forcimin e qeverisjes së korporatave në institucionet financiare.

[27] Neni 10(1) i Ligjit për bankat.

e Ligjit për shoqëritë tregtare gjejnë zbatim për bankat si shoqëri aksionere. Për këtë arsye, dispozitat e Ligjit për shoqëritë tregtare duhet të gjejnë zbatim për bankat për çdo rast kur Ligji për bankat dhe aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij nuk shprehen ose janë të paqarta. Megjithatë, Ligji për bankat duhet të ketë përparësi në rastin e konfliktit ligjor, për dy arsye: Së pari, Ligji për bankat në dallim nga Ligji për shoqëritë tregtare, rregullon një lloj specifik të shoqërive aksionere, ndaj postulati *"lex specialis, derogat legi generali"* është i vlefshëm në këtë rast. Së dyti, nisur nga rëndësia sistemike e bankave, Ligji për bankat duhet të ketë përparësi, nisur edhe nga këndvështrimi dhe arsyet për ruajtjen e stabilitetit financiar dhe të interesit të publikut. Megjithatë, në rastet kur dispozitat e Ligjit për bankat janë të përgjithshme apo të paqarta, mendojmë se autoriteti mbikëqyrës duhet t'i referohet dhe të zbatojë dispozitat e Ligjit për shoqëritë tregtare.

Pjesa e mëposhtme paraqet një vështrim të përgjithshëm të kuadrit ligjor sipas Parimeve të Bazelit për qeverisjen e korporatave të institucioneve financiare.

4.2.1 KUALIFIKIMET DHE KUPTIMI I ROLIT TË ANËTARËVE TË BORDIT

Sipas nenit 134 të Ligjit për shoqëritë tregtare, një shoqëri aksionere e themeluar në Shqipëri duhet të ketë këto organe: asamblenë e përgjithshme të aksionerëve dhe, në varësi të dispozitave të statutit, ose këshillin mbikëqyrës dhe një bord menaxhimi (sistemi me dy nivele), ose këshillin e administrimit (sistemi me një nivel).

Ndryshe nga shoqëritë e zakonshme aksionere, bankat drejtohen nga këshilli drejtues dhe një drejtori (menaxhimi i lartë)[28] dhe nuk kanë këshill mbikëqyrës.[29] Ndryshe nga Ligji i mëparshëm për shoqëritë tregtare, neni 35(1) i Ligjit për bankat parashikon për bankat strukturën vetëm me një nivel. Gjithashtu, këshilli drejtues është si organ vendimmarrës (drejtimi dhe menaxhimi) ashtu edhe organ mbikëqyrës (kontrolli). Ai ia delegon drejtimin e përditshëm një ose më shumë drejtorëve ekzekutivë.

---

[28] Ibid., neni 32.

[29] Ibid., neni 30 (1).

Sipas nenit 35 (2) të Ligjit për bankat, këshilli drejtues duhet të përbëhet nga një numër tek individësh, jo më pak se pesë dhe jo më shumë se nëntë anëtarë.

Ligji për bankat thekson ndjeshëm nevojën për një këshill që është mjaftueshëm i ndarë nga menaxhimi me qëllim ushtrimin e një vendimmarrjeje objektive, për të siguruar llogaridhënien e menaxhimit dhe për t'i dhënë menaxhimit drejtim strategjik. Para ndryshimeve më të fundit, neni 35(4) kërkonte që të paktën një e treta e anëtarëve të këshillit të jenë të jashtëm (të pavarur), domethënë anëtarë të cilët nuk janë të lidhur me marrëdhënie interesash privatë, me bankën, aksionerët ose drejtuesit e saj ekzekutivë. Ndryshimet e bëra në nëntor 2011 parashikojnë që shumica e anëtarëve të këshillit drejtues të jenë të pavarur. Kjo është edhe në përputhje me nenin 155 (1) të Ligjit për shoqëritë tregtare, i cili kërkon që shumica e anëtarëve të këshillit të administrimit të shoqërive aksionere të jenë të pavarur dhe të mos jenë drejtues ekzekutivë.

Më tej, nga pikëpamja e kompozimit, nuk ka një ndarje të plotë të organeve mbikëqyrëse dhe atyre drejtuese, duke pasur parasysh se drejtues ekzekutivë mund të jenë anëtarë të këshillit drejtues, me kusht që të mos përbëjnë shumicën.[30] Interesant është fakti se sipas nenit 167(3) të Ligjit për shoqëritë tregtare, nuk mund të zgjidhen anëtarë të Këshillit Mbikëqyrës administratorët e shoqërisë apo administratorët e shoqërive të tjera të të njëjtit grup, si dhe personat e lidhur me personat e mësipërm. Në mënyrë të debatueshme, kjo dispozitë i konsideron këto lloj marrëdhëniesh si faktorë që cenojnë objektivitetin.

Në këtë pikë, ne e gjykojmë të domosdoshëm analizimin e konceptit të drejtorëve "joekzekutivë" dhe atyre "të pavarur" në një situatë ku pronësia e kapitalit është tejet e përqendruar, sidomos në rastin e një banke të kontrolluar plotësisht nga një bankë mëmë. Ndryshimet e fundit në Ligjin për bankat nuk janë implementuar ende. Sipas dispozitës ligjore të shfuqizuar, këshilli drejtues duhet të kishte të paktën një të tretën e anëtarëve të pavarur, dhe drejtuesit ekzekutivë të mos përbënin shumicën e anëtarëve. Numri

[30] Shih neni 35(7) i Ligjit për bankat.

i mundshëm i anëtarëve të këshillit është 5, 7 dhe 9. Një ushtrim i thjeshtë matematikor tregon se këshilli duhet të ketë të paktën 2 ose 3 drejtorë të pavarur, në varësi të numrit të përgjithshëm të anëtarëve. Duke patur parasysh se drejtuesit ekzekutivë nuk mund të tejkalojnë shumicën e anëtarëve, mbetet të jenë 1 ose 2 drejtues joekzekutivë, ndonëse jo domosdoshmërisht të pavarur. Në përfundim, mendojmë se ky konstrukt ligjor nënkupton se një drejtues joekzekutiv mund të mos jetë domosdoshmërisht i pavarur. Ky mund të ketë qenë dhe arsyetimi për ndryshimet e fundit në Ligjin për bankat.

Në të vërtetë, në Strategjinë Afatmesme të Bankës së Shqipërisë për Mbikëqyrjen Bankare 2009-2014, theksohet rëndësia e pavarësisë së këshillit drejtues të bankave bijave në Shqipëri nga bankat mëma në përmbushjen e përgjegjësive të tyre (Banka e Shqipërisë, 2009). Aty argumentohet se administrimi i pavarur i rreziqeve ndaj të cilave mund të ekspozohen bankat e huaja që operojnë në Shqipëri, siguron parandalimin e vlerësimit jokorrekt të rrezikut dhe maksimizimin e vlerës së aksioneve në afat të gjatë (Banka e Shqipërisë, 2009, f. 11). Të dhënat e marra nga intervista jozyrtare me punonjës të Bankës së Shqipërisë nxjerrin në pah një arsye tjetër. Shqetësimi i tyre kryesor duket të ketë qenë pjesëmarrja e disa aksionerëve në përbërjen e këshillit drejtues, personalisht apo nëpërmjet përfaqësuesve ligjorë, çka sjell implikime negative në rastin e bankave.

Përsa i takon rolit të kryetarit të këshillit drejtues, sipas nenit 35(2) të Ligjit për bankat, ai/ajo duhet të drejtojë dhe organizojë punën e këshillit drejtues. Kryetari dhe zëvendëskryetari, zgjidhen nga anëtarësia e këshillit dhe duhet të jenë drejtues joekzekutivë.[31] Kjo ndarje midis roleve udhëheqëse synon thellimin e dallimit midis funksioneve mbikëqyrëse dhe atyre menaxheriale të këshillit, forcimin e pavarësisë së tij dhe eliminimin e lindjes së mundshme të konfliktit të interesave.

Sipas nenit 37 (ç) të Ligjit për bankat, këshilli drejtues mund t'u delegojë komiteteve të posaçme shumë funksione mbikëqyrëse. Këto komitete ndihmojnë në organizimin e punës së këshillit,

[31] Ibid., neni 35 (8).

veçanërisht kur mund të shfaqet konflikt ndërmjet interesave të bankës dhe atyre të drejtimit të lartë ekzekutiv, sidomos në fushat e auditimit, shpërblimit dhe performancës. Ndonëse ligji nuk shprehet për këtë, pranohet gjerësisht se drejtorët e pavarur duhet të kenë shumicën në komitetet, për shkak të rolit të tyre të veçantë në mbikëqyrjen e mbarëvajtjes së aktivitetit të bankave.[32] Në të vërtetë, komitetet e kompozuara në mënyrën e duhur janë një mjet i efektshëm për një gjykim objektiv mbi çështje kyçe në të cilat drejtimi i lartë ekzekutiv mund të ketë interes personal. Kjo zgjidhje është në përputhje me parimet e OECD-së për qeverisjen e korporatave.[33]

Neni 37(2) i Ligjit për bankat fuqizon këshillin duke e veshur me kompetencën e mbikëqyrjes së funksionit të auditimit, i cili është kyç për ruajtjen e besimit të aksionerëve dhe depozituesve si dhe integritetin e tregjeve.

Sipas nenit 42, anëtarët e këshillit - si dhe drejtuesit e lartë, dhe drejtori i njësisë së auditimit[34], për t'u emëruar përfundimisht në detyrë duhet të marrin *a priori* miratim nga Banka e Shqipërisë. Kërkesat për miratimin, largimin, shkarkimin, pushimin e administratorëve përcaktohen në rregulloren "Mbi parimet bazë të drejtimit të bankave dhe degëve të bankave të huaja dhe kriteret për miratimin e administratorëve të tyre."

Cilësia, përvoja, dhe pavarësia e anëtarësisë së këshillit janë faktorë përcaktues për aftësinë e këshillit drejtues për të përmbushur funksionet dhe detyrat e tij. Prandaj, është e domosdoshme që anëtarët e Këshillit të kenë kualifikimet e nevojshme, reputacionin e mirë dhe ekspertizën për qeverisje dhe mbikëqyrje efektive. Kriteret e kualifikimit përfshijnë si rregull diplomë universitare ose pasuniversitare në ekonomi ose jurisprudencë, ose në rast të kundërt të paktën pesë vjet përvojë pune në sektorin bankar, reputacion të mirë, dhe të paktën tri vjet përvojë në sektorin financiar, administrimin e rrezikut në tregjet financiare, administrimin

[32] Kjo pranohet shprehimisht te neni 161(4) i Ligjit për shoqëritë tregtare dhe neni 44(5) i Ligjit për bankat, sipas të cilëve Këshilli mund të ngrejë komitete të posaçme të përbëra nga drejtues joekzekutivë për të trajtuar raste ku ka konflikt interesi.

[33] Shih OECD 2004.

[34] Shih neni 4(19) i Ligjit për bankat.

financiar, mbikëqyrjen financiare/bankare, biznes, auditim, përvojë ligjore ose akademike të lidhur me tregjet financiare.[35]

4.2.2 OBJEKTIVAT STRATEGJIKË DHE VLERAT E KORPORATËS

Sipas nenit 37(1) të Ligjit për bankat, "anëtarët e këshillit drejtues, gjatë ushtrimit të kompetencave të tyre, drejtohen nga standardet më të larta të etikës dhe veprojnë duke u mbështetur në informacion të plotë dhe të mjaftueshëm, në mirëbesim, me kujdesin dhe përgjegjësinë e duhur, me përkushtim të plotë ndaj përgjegjësive të tyre dhe në interesin më të mirë të sigurisë dhe të qëndrueshmërisë së veprimtarisë bankare dhe financiare të klientëve dhe aksionerëve të tyre".

Përveç sa më sipër, këshilli drejtues është përgjegjës për përcaktimin e objektivave afatgjatë të bankës dhe monitorimin e realizimit të këtyre objektivave, miratimin dhe kontrollin e zbatimit të politikave dhe strategjive të bankës, në lidhje me planin e biznesit, me administrimin e rrezikut dhe me buxhetin vjetor.[36]

4.2.3 LINJA TË QARTA PËRGJEGJËSIE DHE LLOGARIDHËNIEJE

Llogaridhënia e organeve mbikëqyrëse dhe drejtuese mbi veprimtaritë e kompanisë është një temë qendrore e qeverisjes së korporatave. Duke qenë se kjo çështje nuk trajtohet në Ligjin për bankat, Banka e Shqipërisë ka nxjerrë rregulloren "Për parimet bazë të drejtimit të bankave dhe degëve të bankave të huaja", e cila përcakton rolet e këshillit drejtues dhe të drejtorisë në lidhje me parimet e qeverisjes së korporatave. Përveç sa më sipër siç u shpjegua dhe më lart, mbi organet e bankave të cilat themelohen si shoqëri aksionere, gjejnë zbatim edhe dispozitat përkatëse të Ligjit për shoqëritë tregtare. Sipas nenit 163 (2) të këtij Ligji, administratorët dhe anëtarët e këshillit të administrimit përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, gjatë përmbushjes së detyrave të tyre, me përjashtim të rasteve kur veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

---

[35] Ibid, neni 13(2) dhe neni 2 i Ligjit për bankat.

[36] Ibid, neni 37 (2, a, b).

Drejtuesit e lartë janë një ose më shumë drejtorë ekzekutivë - përfshirë drejtorin e përgjithshëm, zëvendësdrejtorin dhe drejtuesit e departamenteve, të cilët janë përgjegjës për mbikëqyrjen e drejtimit të përditshëm të bankës[37]. Këta individë duhet të përmbushin të njëjtat kërkesa për kualifikimin e duhur, reputacion të mirë dhe përvojë ashtu si edhe anëtarët e këshillit drejtues. Emërimi i tyre është gjithashtu subjekt i miratimit paraprak nga Banka e Shqipërisë.

Drejtimi i lartë mbikëqyr drejtuesit e departamenteve sipas fushave të caktuara të biznesit dhe aktivitetit në përputhje me politikat dhe procedurat e miratuara nga këshilli drejtues i bankës.

4.2.4 MBIKËQYRJA E DUHUR NGA DREJTIMI I LARTË

Një prej roleve kyçe të drejtimit të lartë është përcaktimi, nën drejtimin e këshillit drejtues, i një sistemi të efektshëm të kontrollit të brendshëm.[38] Objektivat kryesorë të sistemit të kontrollit të brendshëm janë:[39]

- vlerësimi i eficiencës së bankës në ushtrimin e aktivitetit dhe në përdorimin e aktiveve;
- sigurimi i informacionit të përshtatshëm, të saktë dhe të besueshëm të gjendjes financiare dhe drejtimit të bankës;
- sigurimin e përputhshmërisë me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, si dhe zbatimin e politikave, të rregullave dhe procedurave të brendshme, të miratuara nga këshilli drejtues ose drejtoria.

Sipas nenit 37(2) të Ligjit për bankat, përgjegjësia finale për krijimin dhe mbarëvajtjen e një sistemi të duhur dhe efektiv të kontrollit të brendshëm është e këshillit drejtues. Sikur se u vu në dukje më lart, Ligji për bankat sanksionon ngritjen e një komiteti të kontrollit të brendshëm i cili ndihmon këshillin drejtues në përmbushjen e përgjegjësive të tij në këtë fushë. Komiteti i kontrollit

[37] Shih nenin 39 të Ligjit për bankat.

[38] Shih nenin 45 të Ligjit për bankat.

[39] Shih nenin 4(2) të Rregullores për sistemin e kontrollit të brendshëm të bankave dhe degëve të bankave të huaja, miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, Vendim Nr. 24, datë 26.3.2008.

është përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit dhe implementimit të procedurave kontabël dhe të sistemit të kontrollit të brendshëm të bankës[40]. Po ashtu, njësia e kontrollit të brendshëm ka për detyrë t'i raportojë komitetit të kontrollit mbi rezultatet dhe gjetjet nga veprimtaria të tij audituese[41].

Nga ana tjetër, drejtimi i lartë është përgjegjës për zbatimin e politikave dhe procedurave të përcaktuara nga këshilli, përfshirë identifikimin, matjen, monitorimin dhe kontrollin e rreziqeve.[42] Në këtë drejtim, drejtuesi ekzekutiv bashkërendon punën me drejtuesit e departamenteve për të ndërmarrë masat korrigjuese të miratuara nga drejtimi i lartë gjatë zbatimit të gjetjeve dhe rekomandimeve të njësisë së kontrollit të brendshëm.

4.2.5 KONTROLLI EFEKTIV I BRENDSHËM DHE I JASHTËM

Siç u përmend, Ligji për bankat parashikon ngritjen e një komiteti kontrolli si organ këshillues për këshillin drejtues[43]. Sipas nenit 38(3), komiteti i kontrollit është përgjegjës për mbikëqyrjen e procedurave kontabël dhe të kontrollit të brendshëm; propozimin e ekspertit kontabël të autorizuar; shqyrtimin e raporteve të kontrollit të brendshëm; dhe kontrollin e përputhshmërisë së veprimtarisë së bankës me aktet ligjore dhe nënligjore.

Në ndryshim nga Ligji i vjetër për bankat, i riu parashikon që anëtarët e komitetit të kontrollit nuk duhet të jenë punonjës ose drejtues ekzekutivë të bankës. Gjithsesi, ata mund të jenë anëtarë të këshillit drejtues. Ky rregullim synon objektivitet dhe pavarësi të mjaftueshme të komitetit në përmbushjen e detyrave të tij. Përveç kësaj, anëtarët duhet të kenë të paktën 3 vjet përvojë në fushën e kontabilitetit ose auditimit.

Sipas nenit 37 (2, ç) të Ligjit për bankat, këshilli drejtues mund të ngrejë edhe komitete të tjera me funksione këshillimore për trajtimin e çështjeve me interes të veçantë.

---

[40] Shih neni 38(3, a) i Ligjit për bankat.

[41] Shih nenet 10, 18 dhe 22 të Rregullores "Për sistemin e kontrollit të brendshëm në bankat dhe në degët e bankave të huaja", supra 38.

[42] Ibid., neni 9.

[43] Shih neni 38 (7).

4.2.6 POLITIKAT E KOMPENSIMIT

Përcaktimi i kompensimit të drejtuesve ekzekutivë është një funksion kyç i organit mbikëqyrës – Këshillit Drejtues. Ky funksion përcaktohet nga neni 37(2, d) i Ligjit për bankat.[44] Gjithashtu, rregullorja e Bankës së Shqipërisë "Për parimet bazë të administrimit"[45] i cakton këshillit përgjegjësinë për miratimin e politikave dhe rregullave për shpërblimin në përputhje me strategjitë, objektivat afatgjatë të bankës, performancën dhe zhvillimin e saj. Rregullorja i njeh të drejtën këshillit drejtues që sipas gjykimit të tij të ngrejë një komitet të shpërblimit. Këshilli ose komiteti ngarkohen me përgjegjësinë për mbikëqyrjen e zbatimit të këtyre politikave në përputhje me parimet e përmendura më lart.

Megjithatë, Ligji për bankat dhe rregullorja nuk trajtojnë çështjen e skemave të shpërblimit të anëtarëve të këshillit drejtues që janë edhe drejtorë ekzekutivë, si dhe detyrimin për publikimin e tyre. Pavarësisht nga kjo, neni 160 i Ligjit për shoqëritë tregtare mund të gjejë zbatim në këtë rast. Ai parashikon se anëtarëve të këshillit mund t'u jepen shpërblime shtesë, përveç pagës bazë, përfshirë pjesë nga fitimi i shoqërisë apo të drejta opsioni mbi aksionet e shoqërisë për punën e tyre, ndërsa pagës së drejtuesve ekzekutivë mund t'i shtohen incentiva të tjera.[46] Këto skema të shpërblimit dhe mënyra e zbatimit të tyre duhet të vihen në dispozicion të aksionerëve dhe aktorëve të tjerë të interesuar, si dhe të publikohen në raportin vjetor të shoqërisë aksionere.[47]

4.2.7 TRANSPARENCA

Sipas nenit 53 të Ligjit për bankat, banka ka detyrimin të publikojë gjendjen e saj financiare dhe pozicionin ndaj rreziqeve në raportet e saj periodike dhe atë vjetor. Ky informacion mund të publikohet në faqen e internetit të bankës, në raportet e saj, në raportimet që i bëhen Bankës së Shqipërisë ose me ndonjë mjet

---

[44] Krahasuar me nenin 154(1, f) të Ligjit për shoqëritë tregtare, i cili parashikon rregulla të detajuara për shpërblimin e organeve drejtuese të kompanive aksionere.

[45] Neni 10 supra et 23.

[46] Neni 160(1) i Ligjit për shoqëritë tregtare.

[47] Ibid. Neni 160(4).

tjetër të përshtatshëm publikimi.[48] Informacioni, objekt i publikimit përfshin:

- veprimtaritë për të cilat janë licencuar, si dhe strukturën e aksionerëve, strukturën e organeve drejtuese dhe strukturën organizative[49];
- gjendjen financiare dhe ecurinë[50];
- politikat kontabël të përdorura për përgatitjen e pasqyrave financiare.[51]

Në lidhje me publikimin e praktikave të qeverisjes së korporatave, neni 134 (2) i Ligjit për shoqëritë tregtare parashikon kërkesa më të detajuara detyruese edhe për bankat si shoqëri aksionere. Sipas këtyre dispozitave, raporti vjetor duhet të përfshijë një dokument shpjegues dhe të përditësuar në lidhje me parimet e rregullat kyçe të qeverisjes së korporatave dhe praktikat, që ndiqen prej tyre. Në lidhje me menaxhimin, kjo deklaratë duhet të përmbajë një profil të drejtuesve ekzekutivë dhe të anëtarëve të këshillit, si dhe të shpjegojë në mënyrë të detajuar, përse secili nga drejtorët ekzekutivë apo anëtarët e këshillit janë të kualifikuar për të kryer detyrat, sipas profileve të tyre. Ata janë të ngarkuar me përgjegjësi ligjore për vërtetësinë e kësaj deklarate.[52]

Informacioni i mësipërm vlen për t'u dhënë depozituesve dhe klientëve të tjerë një pamje të qartë e të plotë të performancës financiare dhe të qeverisjes së bankës si një instrument për ndërtimin e besimit të publikut dhe disiplinimin në bazë tregu.

---

[48] Shih Rregulloren e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, Nr. 60, datë 29.08.2008 "Për kërkesat minimale të publikimit të informacionit nga bankat dhe degët e bankave të huaja", neni 7; Buletini Zyrtar i Bankës së Shqipërisë, vëllimi 10, nr. 7, gusht 2008, f. 28.

[49] Ibid., neni 9.

[50] Ibid., neni 11.

[51] Ibid., neni 12.

[52] Neni 164 i Ligjit për shoqëritë tregtare.

4.3 QEVERISJA E KORPORATAVE E ZBATUAR NË SEKTORIN BANKAR

Nga analiza jonë, deri tani, rezulton se qeverisja e korporatave në Shqipëri ka përqafuar modelin e "ndikimit të brendshëm të qeverisjes". Sikurse u theksua tashmë, ky model ka si veçori pronësinë e përqendruar dhe përfshirje të lartë të aksionerëve në menaxhimin e kompanisë, më shumë monitorim dhe kontroll mbi menaxhimin, shumë pak raste të shfaqjes së problemeve të agjencisë, dhe në përgjithësi inkurajim të strategjive afatgjata dhe të qëndrueshmërisë. Nga ana tjetër, ky model mund të shkaktojë konflikt interesi midis aksionerëve të shumicës dhe atyre të pakicës, si për shembull shpronësim potencial të aksionerëve të pakicës. Për më tepër, konflikti i interesit mund të lindë edhe ndërmjet aksionerëve dhe aktorëve të tjerë.

Për një qeverisje të mirë të korporatave, roli i këshillit drejtues në ruajtjen/sigurimin e balancës midis aksionerëve, aktorëve të tjerë të interesuar dhe menaxhimit, është vendimtar. Ashtu siç u argumentua më lart, në rastin e bankave ky rol i këshillit merr rëndësi edhe më të veçantë. Sipas Bazelit, "Në fakt, përveç përgjegjësisë ndaj aksionerëve, bankat kanë edhe përgjegjësi ndaj depozituesve dhe aktorëve të tjerë të interesuar të njohur si të tillë" (Bazel 2010, f. 5). Rëndësia e këshillit drejtues i ka themelet në përgjegjësinë e këtij organi më të lartë të drejtimit për të siguruar besimin e publikut në sistemin bankar. Kjo për arsye se një qeverisje e dobët e korporatave mund të çojë në dështimin e bankës dhe për shkak të ndjeshmërisë së lartë të publikut ndaj këtyre fenomeneve, kjo goditje mund të përhapet në të gjithë sistemin financiar.

Në vijim, do të përqendrohemi në aplikimin në praktikë të dy aspekteve të qeverisjes së korporatave: këshilli drejtues dhe transparenca.

4.3.1 PAVARËSIA E KËSHILLIT DREJTUES NË BANKAT SHQIPTARE

Pavarësia e këshillit drejtues është e matshme në mënyrë të drejtpërdrejtë nëpërmjet numrit të anëtarëve të pavarur në të.

Ajo është tepër e domosdoshme për një gjykim objektiv dhe llogaridhënie të këshillit drejtues përsa i përket monitorimit të menaxhimit, përcaktimit të objektivave strategjike dhe parandalimit të konfliktit të interesit. Gjithashtu, anëtarët e pavarur në këshill kontribuojnë ndjeshëm në procesin e vendimmarrjes, sidomos në fusha ku interesi i menaxherëve, kompanisë dhe aksionerëve të saj mund të mos përputhet, si për shembull në lidhje me shpërblimin dhe përcaktimin e planit të sukcesimit *(succession planning)* të drejtuesve ekzekutivë (OECD, 2004).

Komiteti i Bazelit për Mbikëqyrjen Bankare e përforcon këtë parim duke shprehur se: "Bankat duhet të kenë një numër të mjaftueshëm dhe përbërje të duhur të anëtarëve të bordit drejtues, që janë në gjendje të ushtrojnë gjykim të pavarur nga pikëpamjet e menaxhimit, interesave politike apo të interesave të jashtme të papërshtatshme (Bazel, 2010, f. 11).

Megjithatë, ky tregues dhe matës i drejtpërdrejtë siç është numri i anëtarëve të pavarur të këshillit drejtues nuk është i mjaftueshëm, pasi pavarësia e këtij organi varet konsiderueshëm edhe nga integriteti personal dhe etika e biznesit e secilit anëtar.

Më poshtë do të analizojmë zbatimin në praktikë të kërkesave të Ligjit për Bankat mbi kompozimin e përbërjes së Këshillit Drejtues. Në një vrojtim të kryer nga Banka e Shqipërisë në vitet 2010 dhe 2011 (Banka e Shqipërisë 2010 dhe 2011), mbi kompozimin e përbërjes së këshillit drejtues në banka dhe praktikat e tij, rezulton se numri i anëtarëve të pavarur është shumë i ulët. Sipas vrojtimit të vitit 2010, anëtarët e pavarur përbëjnë pothuajse më pak se një të tretën në më shumë se gjysmën e bankave, pra, ato nuk përmbushin kërkesën ligjore. Duke besuar se përgjigjet mund të mos kenë qenë të sakta për shkak të paqartësisë në lidhje me përkufizimin e termit "i pavarur", vrojtimi u ndryshua në vitin 2011, duke e qartësuar kuptimin e "pavarësisë". Fatkeqësisht, vrojtimi i dytë, jo vetëm që përforcoi rezultatet e mëparshme, po nxorri në pah se shumë nga bankat sipas përkufizimit të dhënë të pavarësisë nuk kishin as dhe një anëtar të pavarur në këshillin e tyre drejtues. Tabela 4.3 ilustron rezultatet e të dy vrojtimeve.

Tabelë 4.3 Numri i anëtarëve të pavarur në këshillat drejtues të bankave shqiptare.

Bankat	Numri i drejtorëve të pavarur ndaj numrit gjithsej të anëtarëve të këshillit (%) Vrojtimi 2010	Numri i drejtorëve të pavarur ndaj numrit gjithsej të anëtarëve të këshillit (%) Vrojtimi 2011
B1	1 nga 6 (16.7%)	1 nga 5 (20%)
B2	1 nga 7 (14.3%)	2 nga 7 (29%)
B4	1 nga 5 (20%)	0 nga 5 (0%)
B5	3 nga 5 (60%)	0 nga 4 (0%)
B7	4 nga 4 (100%)	2 nga 4 (50%)
B9	3 nga 7 (42.9%)	2 nga 7 (29%)
B10	1 nga 5 (20%)	2 nga 5 (40%)
B11	0 nga 6 (0%)	0 nga 6 (0%)
B12	0 nga 5 (0%)	0 nga 5 (0%)
B13	4 nga 5 (80%)	1 nga 5 (20%)
B14	2 nga 7 (28.6%)	2 nga 7 (29%)
B15	N/A*	0 nga 5 (0%)
B8	N/A*	0 nga 9 (0%)
B16	2 nga 5 (40%)	3 nga 5 (60%)

Burimi: Banka e Shqipërisë 2010, 2011.

Ne sugjerojmë se një shpjegim i mundshëm i këtyre rezultateve mund të jetë mosvendosja e kërkesave strikte për një këshill drejtues të pavarur nga ana e aksionerëve të bankave. Kjo duket më e mundshme për faktin se pjesa më e madhe e bankave që operojnë në Shqipëri janë në pronësi 100% të bankave mëma. Këto rezultate japin të dhëna të qenësishme mbi shqetësimin e Bankës së Shqipërisë, të adresuar në Strategjinë e Zhvillimit të Mbikëqyrjes Bankare (Banka e Shqipërisë, 2009, f. 21). Ato justifikojnë nxjerrjen e rregullores së re "Për pavarësinë e anëtarëve të këshillit drejtues", duke zgjeruar fokusin e autoritetetit rregullator si agjent i interesit të publikut. Megjithatë, marrja e masave rregullative si miratimi i ligjeve, rregulloreve dhe kodeve nuk është e mjaftueshme për të garantuar një qeverisje të mirë të korporatave, siç ilustrohet më mirë në Tabelën 4.3. Analizat tona në seksionet 3.1 dhe 3.2.2 të këtij punimi, nxjerrin në pah se kompozimi i përbërjes së këshillit drejtues në Shqipëri nuk ndryshon nga ajo në vendet e tjera të EJL-së, duke reflektuar kështu një strukturë të përqendruar të pronësisë.

4.3.1.1 A miratojnë dhe mbikëqyrin këshillat drejtues objektivat strategjikë?

Sipas parimeve të Bazelit, "Këshilli ka përgjegjësi të plotë për bankën, përfshirë miratimin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të objektivave strategjikë të saj, të strategjisë së rrezikut, qeverisjen e korporatave dhe vlerat e saj. Gjithashtu, Këshilli është përgjegjës për mbikëqyrjen e menaxhimit të lartë" (Bazel, 2010, Parimi 1).

Mund të pranohet se praktikisht, politikat e bankave dhe objektivat strategjikë të saj imponohen drejtpërdrejt nga bankat mëmë apo aksionerët e mëdhenj. Sipas vrojtimit të Bankës së Shqipërisë 2011, shumica e bankave që janë degë apo filiale të bankave të huaja konfirmuan se objektivat strategjikë janë të lidhur ngushtë dhe të përcaktuar nga politikat dhe strategjitë e aksionerit të huaj/bankës mëmë (Banka e Shqipërisë 2010 - 2011). Grafiku 4.4 ilustron nivelin e ndikimit nga aksioneri kryesor në vendime strategjike.

Grafik. 4.4 Roli i aksionerëve në vendime strategjike.
Sa varet përcaktimi i objektivave strategjikë nga aksioneri/banka e huaj (në rastin kur banka është filial i një banke të huaj) apo nga banka mëmë (në rastin kur banka është degë e një banke të huaj)?



Burimi: Banka e Shqipërisë, 2011.

Ndërsa mund të pranohet si e arsyeshme që bankat e huaja të mëdha t'i lidhin objektivat strategjike me bankën mëmë, ne besojmë se kjo dukuri është problematike në rastin e subjekteve të pavarura - bankat e themeluara dhe të regjistruara në Shqipëri. Ne besojmë se kjo do të ushtronte trysni të konsiderueshme mbi këshillin drejtues dhe menaxhimin për përmbushjen e objektivave

strategjikë të imponuar paraprakisht, aq sa mund të shtyjnë në marrje potenciale të një rreziku më të madh.

4.3.2 ÇFARË MENDOJNË BANKAT PËR KUALIFIKIMET E ANËTARËVE TË KËSHILLIT?

Në përgjithësi, për të kuptuar qartë parimet e biznesit dhe për të marrë vendime strategjike, anëtarët e këshillit duhet të jenë të mirëkualifikuar. Procesi i vendimmarrjes duhet të mbështetet nga kualifikime në fushën e kontabilitetit, planifikimit strategjik, administrimit të rrezikut, raportimit financiar, etj. Parimet e Bazelit për qeverisjen e bankave i inkurajojnë këto të fundit të kryejnë trajnime dhe edukim të vazhdueshëm të anëtarëve të këshillit ose të ndërmarrin hapa të tjerë për të siguruar se ata kanë njohuri të mjaftueshme për të përmbushur përgjegjësitë e tyre (Bazel, 2010, Parimi 2).

Fokusi mbi këtë aspekt të qeverisjes së korporatave është vendosur nisur nga rezultatet e vrojtimit të Bankës së Shqipërisë 2011. Dhjetë banka dhanë përgjigje negative për pyetjen: "A janë bankat duke zhvilluar programe trajnimi/edukimi për anëtarët e këshillit lidhur me qeverisjen e korporatave?" Grafiku 4.5 tregon shpërndarjen e përgjigjeve.

Grafik. 4.5 Kualifikimet e këshillit

A zhvillon banka juaj programe/trajnime për edukimin e anëtarëve të këshillit drejtues (në rastet kur mungojnë njohuritë përkatëse apo shihet e nevojshme rritja dhe përditësimi i këtyre njohurive) duke i dedikuar kohë, fonde dhe burime të tjera



Burimi: Banka e Shqipërisë, 2011.

4.3.3 A I PËRMBUSHIN BANKAT KËRKESAT LIGJORE PËR PUBLIKIMIN E INFORMACIONIT DHE TRANSPARENCËN?

Siç u përmend më parë, studimet e BERZH (2010) dhe OECD (2003) tregojnë se transparenca dhe publikimi i informacionit mbeten pikat më të dobëta të qeverisjes së korporatave në Shqipëri dhe vendet e EJL-së në përgjithësi. Modeli i zbatuar i qeverisjes së korporatave, kërkesa e ulët për pasqyra financiare cilësore dhe të besueshme, së bashku me një treg jofunksional të aksioneve në Shqipëri, janë ndër faktorët kyç që pengojnë transparencën dhe publikimin e informacionit. Parimi 14 i Bazelit parashtron se: "Ndonëse transparenca mund të jetë më pak e hollësishme për bankat e palistuara, sidomos ato që zotërohen plotësisht, këto institucione, megjithatë, mund të paraqesin të njëjtat lloje rreziku ndaj sistemit financiar ashtu si edhe bankat e tregtueshme publikisht, nëpërmjet veprimtarive të ndryshme, përfshirë pjesëmarrjen e tyre në sistemet e pagesave dhe pranimin e depozitave nga klientë të vegjël" (Bazel, 2010, pika 124).

Raportet vjetore të publikuara nga bankat në Shqipëri paraqesin kryesisht informacion vetëm në lidhje me pasqyrat financiare. Disa informacione lidhur me qeverisjen mund të gjenden në faqen e tyre të internetit. Megjithatë, informacioni është i kufizuar deri në paraqitjen e strukturës organizative dhe të përbërjes së këshillit drejtues, duke shkelur qartë standardet e qeverisjes së mirë dhe kërkesat e Ligjit për shoqëritë tregtare.[53] Në bazë të vrojtimeve, i njëjti përfundim konstatohet nga Banka e Shqipërisë. Përgjigjet e bankave lidhur me publikimin e informacionit për politikat e shpërblimit, kompensimin e anëtarëve të këshillit dhe drejtuesve ekzekutivë, bonuset, opsionet e pjesëmarrjes në aksione, tregojnë se vetëm gjysma e bankave e përfshijnë këtë informacion në raportet e tyre vjetore ndërsa gjysma tjetër e konsideron këtë informacion si konfidencial.

4.3.4 REZULTATET E ANALIZAVE

Nga këndvështrimi rregullator dhe institucional, sektori bankar në Shqipëri është i mirorganizuar, Bankat kanë linja të qarta raportimi

[53] Neni 134(2).

për gjetjet e audituesve (të brendshëm dhe të jashtëm), dhe shpesh rekomandimet mund të trajtohen nga këshilli. Megjithëse, bankat janë ndër të vetmet shoqëri aksionere në Shqipëri që kanë praktika të mira dhe të matshme të qeverisjes së korporatave, ato kanë nevojë për përmirësime përsa i përket cilësisë së këshillit drejtues dhe transparencës. Meqenëse forcat e jashtme për një qeverisje të mirë të korporatave janë të dobëta në Shqipëri, autoriteti mbikëqyrës mund të jetë më agresiv në forcimin e qeverisjes së bankave. Ky rol nuk do të thotë aktivitet më të lartë ligjor dhe rregullator, por presion të shtuar mbi bankat për një qeverisje më të mirë.

Gjithashtu, është e rëndësishme që aksionerët të rrisin vëmendjen mbi qeverisjen e mirë të korporatave dhe të kuptojnë peshën e saj në performancën e kompanisë. Është e vërtetë se ky nuk është një parakusht i domosdoshëm, duke qenë se faktorë të tjerë që ndikojnë mbi performancën, e bëjnë këtë korrelacion jo domethënës. Megjithatë, ne argumentojmë se për bankat që operojnë në Shqipëri, ky korrelacion ekziston dhe është pozitiv. Një studim mbi lidhjen e indeksit të qeverisjes së korporatave me performancën, Kodra dhe Kalluci (2011, f. 17) kanë arritur në përfundimin se: "Bankat me indeks më të lartë qeverisjeje (që do të thotë se janë më të rregulluara dhe të organizuara në kuadrin e tyre për qeverisjen) vërtetuan se gjeneruan më shumë të ardhura neto në raport me kapitalin dhe aktivet e tyre".

5. PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

Në këtë punim, analizojmë kuadrin e qeverisjes së korporatave në sektorin bankar shqiptar. Meqenëse nuk ka hulumtime të plota akademike për këtë temë në Shqipëri, ne paraqesim fillimisht një përmbledhje thelbësore teorike të veçorive dalluese të modeleve kryesore të qeverisjes së korporatave, sidomos të atyre të zhvilluara pas krizave financiare globale të viteve 2007-2009.

Analiza jonë tregon se një qeverisje e shëndoshë e korporatave dhe një rol i fortë i rregullatorit financiar kanë rëndësi tejet të madhe, pavarësisht fazës së zhvillimit të ekonomisë së një vendi. Ndonëse kriza financiare zbuloi se procesi i derregullimit në vendet e zhvilluara nuk u shoqërua nga praktika të duhura të vetërregullimit në aspektin e qeverisjes së korporatave, të cilat duhej të inkurajoheshin nga forca të jashtme të tregut, vendet në tranzicion si Shqipëria hasin gjithashtu "hendeqe" të ngjashme, por me një natyrë dhe për shkaqe të tjera. Siç paraqitet, pavarësisht kuadrit ligjor me standarde të larta në Shqipëri, sundimi i dobët i së drejtës, veçanërisht në mbrojtjen e së drejtës mbi pronësinë, mbrojtjen ligjore të investitorëve, zbatimin e dobët të ligjit si dhe korrupsioni, apelon për një rol më aktiv të rregullatorëve bankarë në vendet në tranzicion. Rregullatorët supozohet të kenë më shumë incentiva sesa gjyqtarët, duke qenë se në bazë të mandatit të tyre ligjor veprojnë dhe janë drejtpërdrejt përgjegjës për mbrojtjen e interesit të publikut dhe stabilitetin financiar të vendit.

Analiza e kuadrit ligjor shqiptar tregon se modeli i qeverisjes së korporatave i dizenjuar nga përmbajtja gjuhësore e ligjit (*letter of law*) është një kombinim i modelit të ndikimit të jashtëm dhe atij të brendshëm, duke ndjekur përqasjen e Bashkimit Evropian. Megjithatë, mungesa e një tregu funksional të kapitalit dhe forcave të tjera të jashtme të tregut shtyjnë drejt modelit të ndikimit të brendshëm, ku bankat sigurojnë burimin kryesor të financimit. Në këtë mjedis, bankat shqiptare marrin një rol kyç në konsolidimin e praktikave të mira të qeverisjes së korporatave në treg. Përveç kësaj, duke patur parasysh rëndësinë shoqërore dhe sistemike të bankave në ekonominë shqiptare, mangësitë e lartpërmendura (mungesa e forcave të jashtme) apelojnë për më shumë vëmendje mbi qeverisjen e bankave.

Bankat shqiptare qeverisen sipas modelit të ndikimit të brendshëm, ashtu sikurse kompanitë e tjera të zakonshme në Shqipëri. Megjithatë, modeli ka veçori të tjera si rezultat i rregullimit bankar dhe strukturës tejet të përqendruar të pronësisë.

Bankat shqiptare, në bazë të Ligjit për shoqëritë tregtare dhe kërkesave specifike të Ligjit për bankat, themelohen si shoqëri aksionere. Ky fakt i thjeshtë shërben si provë për veçorinë plotësuese që ekziston në lidhjen ndërmjet praktikave të qeverisjes së korporatave dhe rregullimit bankar. Ndërkohë që Ligji për bankat e dizenjon qeverisjen e brendshme të bankave si proces të brendshëm biznesi nga këndvështrimi i stabilitetit financiar, Ligji për shoqëritë tregtare përcakton parimet e qeverisjes së korporatave nga një këndvështrim më i gjerë, duke i trajtuar bankat thjesht si shoqëri aksionere. Ne besojmë se këto akte ligjore, së bashku me rregulloret e Bankës së Shqipërisë, sigurojnë një bazë solide për forcimin e qeverisjes së bankave.

Megjithatë, duke pasur parasysh strukturën tejet të përqendruar të pronësisë së bankave, arrihet në përfundimin se këshilli drejtues nuk ka pavarësinë e mjaftueshme nga bankat mëmë, duke mos plotësuar kërkesën e Ligjit shqiptar për bankat. Me këtë nivel pavarësie (ose mungesën e saj), instrumenti i huadhënësit të fundit dhe ai i sigurimit të depozitave mund të jenë nxitës potencialë për aksionerët që të ndërmarrin rrezik më të madh. Ne gjejmë se bankat mëma kanë ndikim përtej një niveli të arsyeshëm në përcaktimin e objektivave të performancës afatgjatë për bankat bija në Shqipëri. Kjo ngre pyetjen nëse objektivat strategjikë janë mbështetur në kushtet e tregut shqiptar dhe nëse ata marrin parasysh interesin e publikut. Ndaj, ne argumentojmë se, përveç ngadalësimit të rritjes ekonomike dhe mangësive në ekzekutimin e kolateralit, niveli i lartë dhe në rritje aktualisht i kredive me probleme në sektorin bankar shqiptar mund të jetë pjesërisht rrjedhojë edhe e nivelit të ulët të pavarësisë dhe cilësisë së këshillave drejtues në përgjithësi.

Përveç pavarësisë, një përcaktues kyç për performancën e mirë të këshillit drejtues është njohuria dhe edukimi kolektiv, e cila varet nga harmonizimi i kualifikimeve, aftësive dhe përvojës profesionale të anëtarëve të tyre. Analiza jonë tregon se kjo çështje nuk ka marrë vëmendjen dhe masat e duhura zbatuese.

Ne gjejmë të dhëna të cilat provojnë se Banka e Shqipërisë po i kushton një vëmendje në rritje praktikave të qeverisjes në banka, duke i perceptuar këto të fundit si burime endogjene të stabilitetit financiar, sipas parimeve të Bazelit dhe udhëzimeve të BE-së. Ky angazhim parashikohet në Strategjinë Afatmesme të Zhvillimit për Mbikëqyrjen Bankare 2009-2014 dhe është materializuar me ndërhyrje të shumta rregullatore gjatë dhe pas krizës financiare. Fokusi kryesor ka qenë mbi rolin dhe pavarësinë e këshillit drejtues të bankave. Megjithatë, ne gjejmë se ka ende vend për masa korrigjuese, ku Banka e Shqipërisë mund të jetë më aktive në veprimet dhe reformat e saj përsa i takon zbatimit të kërkesave ligjore të miratuara së fundi mbi pavarësinë e këshillit drejtues. Më tej, ne besojmë se këto veprime do të siguronin kushtet e nevojshme për një mbikëqyrje bankare efektive nga pikëpamja e kostove.

Sikurse tregoi kriza financiare globale e kohëve të fundit, qeverisja e mirë e korporatave nuk mbështetet vetëm në kuadrin e duhur ligjor dhe rregullator dhe në "verifikimin rutinë" (*box-checking*) të zbatimit të tij. Banka e Shqipërisë duhet të konsiderojë edhe faktorë të tjerë që ndikojnë mbi cilësinë e qeverisjes së korporatave, të tilla si sjellja njerëzore, praktikat e implementimit, dhe veçoritë specifike të secilës bankë. Për këtë qëllim, ne rekomandojmë zhvillimin e instrumenteve dhe metodologjive efektive për të analizuar me imtësi dhe për të matur në mënyrë korrekte praktikat e qeverisjes së korporatave. OECD-ja dhe IFC-ja kanë përgatitur metodologji, të cilat mund të shërbejnë si bazë për hartimin e metodologjive të përshtatshme për vendin tonë, sipas specifikave të sektorit bankar shqiptar, mjedisit institucional dhe atij ligjor.

BIBLIOGRAFI

Albania Progress Report 2007({COM(2007)663};

Albania Progress Report 2008({COM(2008)674};

Albania Progress Report 2009({COM(2009)533};

Albania Progress Report 2010{COM(2010)},

Albania Progress Report 2011{COM(2011)666)

Arun, T.G. and Turner, J.D. (2004) "Corporate Governance of Banks in Transition Countries: Concepts and Issues" Also available online athttp://www.sed.manchester.ac.uk/idpm/research/publications/wp/depp/documents/depp_wp02.pdf

Banka e Shqipërisë, (2011) "Raporti i Stabilitetit Financiar" 2012 6MII

Banka e Shqipërisë (2010), (2011), "Qeverisja e korporatave në sistemin bankar shqiptar"

Banka e Shqipërisë, (2009) "Strategjia afatmesme e zhvillimit të mbikëqyrjes bankare 2009-2014) miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë me vendimin nr. 65, datë 16.09.2009, Buletini Zyrtar, Vëll. 11 Nr. 8, shtator 2009.

Banka e Shqipërisë (2010) "Dokument për misionin e mbikëqyrjes bankare", Miratuar me vendimin nr. 71, datë 13.10.2010 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

Banca d' Italia (2007) "Supervisory Provisions concerning banks' organization and corporate governance," 1 (n.13)

Basel Committee on Banking Supervision, (2010) "Enhancing Corporate Governance for banking organizations"

Caruana, J. (2005) "Basel II and corporate Governance issues", BIS Review 38/2005. Speech by Jaime Caruana former Governor of the Bank of Spain and Chairman of the Basel Committee on Banking Supervision, at the 2nd Islamic Financial services Board (IFSB) Summit 2005: The Rise and Effectiveness of corporate Governance in the Islamic Financial Services Industry , Doha, 24 May 2005

Ciancianelli P, and J. Gonzales (2000) "Corporate Governance in Banking: A conceptual Framework", Social Science Research Network Electronic Paper Collection: http://papers.ssrn.com/paper.taf?aabstract_id=253714 on October 10th 2011

Claessens, S. (2003)"Corporate Governance and Development" Focus Publications No. 1, Global Corporate Governance Forum. Also available online athttp://www.ifc.org/ifcext/corporategovernancef.nsf/AttachmentsByTitle/Focus_1_CORPORATEGOVERNANCE_and_Development/$FILE/Focus_1_Corp_Governance_and_Development.pdf on December 22nd , 2011

Claessens, S. and Fan, J.P.H (2002) "Corporate Governance in Asia: A survey", International Review of Finance, 3:2, pp. 71 – 103

Clarke, T. and Klettner A. et al (2010) "Chapter 6 - Corporate Governance and the global crisis: The regulatory response", University of Technology, Sydney at "Handbook on Emerging Issues in Corporate Governance" World Scientific, pp. 71- 102

EBA, (2011) "EBA Guidelines on Internal Governance" (GL 44), September 11, 2011, 3. Concept used in the Guidelines, Available at EBA website www.eba.europa.eu

EBRD, (2010) "Commercial laws of Albania, an assessment by EBRD"

Bozdo E, "Për kodin e qeverisjes së shoqërive tregtare", "Panorama" - gazetë e përditshme, gjithashtu e disponueshme në http://www.panorama.com.al/opinion/mbi-kodin-e-qeverisjes-se-shoqerive-tregtare, marrë më 10 dhjetor 2011

European Commission (2010) Green Paper "Corporate Governance in financial institutions and remuneration policies" (COM(2010) 284)

European Commission, Financial Services (1999) "Implementing the framework for financial markets – Action Plan" (COM (1999) 232)

Fullani, A. (2009) "Strategji të politikës monetare për ekonomitë e vogla", Banka e Shqipërisë, publikime joperiodike. Marrë nga http://www.bankofalbania.org/web/Strategjite_e_politikes_monetare_per_ekonomite_e_vogla Ideoi_dhe_pre_5461_1.php> më 2 janar 2012
Goodpaster, K.E. (1991) "Business ethics and stakeholder analysis", Business Ethics Quarterly 4 (4): pp.423-429

International Financial Cooperation (IFC) (2012) "Corporate Governance Assessment Tools" available at http://www.ifc.org/ifcext/corporategovernance.nsf/Content/CORPORATEGOVERNANCETools_FinancialInstitutions, retrieved on January 8th, 2012.

International Monetary Fund (2011), Country Report No. 11/313,

Jarvis, C. (1999) "The rise and fall of pyramid schemes in Albania", IMF staff Papers, Vol. 47, No.1

Kirkpatrick, G. (2009) "The Corporate Governance Lessons from Financial Crisis", Financial Market Trends Also available online at http://www.oecd.org/document/48/0,3343,en_2649_34813_42192368_1_1_1_1,00.html

Kodra, O. dhe Kalluci, I. (2011) "Ndikimi i mirëqeverisjes mbi performancën financiare të bankave në Shqipëri", Material diskutimi, publikimet e Bankës së Shqipërisë

Macey, R.J. and O'Hara, M. (2003) "The corporate Governance of banks" FRBNY Economic Policy Review, April 2003

McGee, R.W., and Preobragenskaya, G.G, (2004)"Corporate Governance in Transition Economies: The Theory and Practice of Corporate Governance in Eastern Europe"

Miawa, Y. and Ramseyer, M.J. (2002) "The myth of main bank: Japan and comparative corporate governance", Law & Social Inquiry, American Bar Foundation.

Minzt, S. (2004) "Improving corporate governance systems: A stakeholder theory approach" Claremont McKenna College

Műlbert, P. (2009) "Corporate Governance of banks after the financial crisis – Theory, Evidence, Reforms", University of Mainz and ECGEI, Law Working Paper N0 130/2009,

Note, S. (2006) "Konkurrenca në sistemin bankar shqiptar", Material diskutimi, publikimet e Bankës së Shqipërisë

OECD,(2003) "White Paper on Corporate Governance in South East Europe". Mund të gjendet edhe në lidhjen http://wwww.oecd.org/dataoecd/9/21/20490351.pdf

OECD, (2007) "Methodology for assessing the Implementation of the OECD principles of Corporate Governance"

"Shekulli", gazetë e përditshme, "Kuvendi hedh poshtë propozimet për ndryshime në ligjin për shoqëritë tregtare"- 25 tetor 2011, i mund të gjendet në lidhjen http://www.shekulli.com.al/shekulli/2011/10/25/kuvendi-kthen-ligjin-e-qeverise-per-shoqerite-tregtare/ marrë më 10 nëntor 2011

Shleifer, A. and Vishny, R. (1997) "A survey of corporate governance" The Journal Of Finance, Vol. LII, No 2

Shull, B. et al (2007) "1. Corporate Governance, bank regulation and activity expansion in the United States" at "Corporate Governance in Banking – A global Perspective", edited by Benton E. Gup

Smerdon, R. (2010)"A practical guide to Corporate Governance", Fourth Edition

Solomon, J. (2010) "Corporate Governance and Accountability", Third Edition

Stephen, F. and Backhaus, J. (2003) "Corporate Governance and mass privatization – A theoretical investigation of transformations in legal and economic relationships", Journal of Economic Studies, Vol. 30, No. 3/4,

Tirana Stock Exchange (2002 - 2010), "Annual Reports", TSE publications

Walker, D. (2009)"A review of corporate governance in UK banks and other financial industry entities – Final Recommendations", November 26, Also available online at http://www.hm-treasury.gov.uk/walker_review_information.htm on November 7th 2011

Wearing, R., (2005) "Cases in corporate Governance", SAGE Publications

CIP Katalogimi në botim BK Tiranë

Roden Pajaj, Rezart Ferzaj
Kuadri ligjor dhe praktika e qeverisjes së korporatave në sektorin bankar shqiptar - /
/Pajaj Roden, Ferzaj Rezart - Tiranë:
Banka e Shqipërisë, 2013

-84 f; 15.3 x 23 cm.

Bibliogr.
ISBN: 978-99956-42-84-1.

Këtë publikim mund ta gjeni edhe në formë elektronike në adresën:

www.bankofalbania.org

Në qoftë se dëshironi të keni kopje të shkruara të tij mund t'i kërkoni në adresën:

Banka e Shqipërisë
Sheshi "Avni Rustemi", Nr. 24, Tiranë, Shqipëri
Tel.: + 355 4 2419301/2/3; + 355 4 2419409/10/11
Faks: + 355 4 2419408
ose duke dërguar një e-mail në adresën:

public@bankofalbania.org

Tirazhi: 420 kopje